

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5648
E shtunë, 8 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €

Annegret Kramp-
Karrenbauer, pasardhësja
e Angela Merkelit në CDU

FAQE 16



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**VESELI: EDHE PAK DITË
FSK-NË DO TA BËJMË USHTRI**

F. 2

**KËRROHET PROFILIZIMI I
PROKURORËVE DHE
GJYQARËVE PËR
PROKURIMIN PUBLIK**

F. 7

**MË 17 DHJETOR NIS PROCESI
I LEGALIZIMIT TË ARMËVE**

F. 5

EKONOMI

**HARADINAJ KËRKON NGA
KEK-U QË TË PRODHOJË
RRYMË**

F. 8

**PARALAJMËROHEN MASA
PËR RITJEN E SIGURISË
NË BANKA**

F. 8

KULTURË



**PIANISTJA SHQIPTARE
QË PO SHKËLOEN NË ZVICËR**

F. 13

Shkruan Ismet RASHITI

SPORT

**SULMUESIT 'LAKMOJNË'
ÇMIMIN E GOLASHËNUESIT**

F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", RAMADAN QEHAJA | FAQE 4-5

Pas mbështetjes së ShBA-së nuk duhet të kemi hamendje për ushtrinë

Njohësi i çështjeve ushtarake dhe të sigurisë, Ramadan Qehaja, ka vlerësuar se reagimi i NATO-s nuk mund ta ndërpresë rrugën për formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Ai ka thënë se nuk do të ketë zbrapsje në këtë drejtim sepse Kosova është shtet i

pavarur dhe vendimet i merr vetë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Qehaja ka thënë se pas mbështetjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) Kosova nuk duhet të ketë hamendje për formimin e ushtrisë. Megjithatë, ai ka thënë se

pavarësisht prej ftohjeve që mund të kenë në këtë periudhë marrëdhëniet në mes të FSK-së dhe NATO-s, në një të ardhme jo të largët situata do të kthehet në normalitet, do të vazhdojë bashkëpunimi i ndërsjellë dhe Kosova do të bëhet pjesë e NATO-s

Gjykata Speciale fton për intervistim komandant 'Remin'

Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) për rajonin e Llapit, Rustem Mustafa- "Remi", është ftuar për intervistim nga zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës në Hagë. Ai më 14 janar të vitit të ardhshëm do të paraqitet pranë Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës (ZPS) në Hagë. Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) dhe ish-komandanti i UÇK-së, Zafir Berisha, këtë



veprim të Speciales e kanë vlerësuar të padrejtë. Ata janë shprehur krenarë me luftën çlirimtare | FAQE 3



**Më 10 dhjetor
KMDLNj-ja dhe
kolegji AAB
organizojnë
tryezë kushtuar
Demaçit**

FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Republika e Kosovës nuk tërhiqet nga formimi i ushtrisë

Veseli: Edhe pak ditë FSK-në do ta bëjmë ushtri

Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë bërë me dije se kanë mbështetjen e nevojshme të NATO-s dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në kapacitete ushtarake. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë theksuar të premtën se kjo nismë po bëhet në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë

"Epoka e re"

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka vizituar Gardën Kombëtare të Iowas, ku ka parë nga afër mënyrën e organizimit dhe ka diskutuar me të për mbështetjen që i është dhënë deri më tani Forcës së Sigurisë së Kosovës. Kryeparlamentari Veseli është pritur nga gjenerali Timothy Orr dhe drejtues të therë të Gardës së Iowas. Gjatë vizitës u konfirmua edhe një herë mbështetja për Forcën e Sigurisë së Kosovës edhe pas transformimit të saj në Ushtri të Kosovës. Kjo mbështetje do të vazhdojë të jepet në trajnime dhe edukim, por edhe në aspekte të tjera që kanë të bëjnë me funksionimin e saj si ushtri. Kryetari Veseli rikonfirmoi se Ushtria e Kosovës do të jetë ushtri e paqes në Ballkan, por edhe në zona të tjera kudo që do të kërkohet angazhimi i saj për ruajtjen e paqes. "FSK-ja ka arritur standardet më të larta profesionale dhe natyrshëm edhe pak ditë do ta bëjmë Ushtri të Kosovës", ka thënë Veseli. Gjenerali Timothy Orr ritheksoi edhe një herë përkrahjen për

Kosovën, në veçanti për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Pas Iowas, kryetari Veseli do të vazhdojë vizitën në ShBA, me takime të rëndësishme në Uashington dhe Nju Jork.

Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka ritheksoar se nuk ka asnjë dilemë rreth votimit të tri projektligjeve për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në kapacitete ushtarake, më 14 dhjetor. Këto komente Haradinaj i bëri të premtën pas një vizite që kishte bërë në Korporatën Energjetike të Kosovës. "NATO-ja është organizatë e disa vendeve të sigurisë dhe mendimi i një anëtarit të NATO-s nuk kthehet në vendim, në fakt vendimet merren vetëm kur të gjithë janë dakord, kështu që ne nuk na pengon puna me NATO-n. Nëse kjo është një kërkesë dhe nuk aprovohet nga të tjerët, kjo nuk ndryshon asgjë", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se qëndrimi i SHBA-së është për më shumë stabilitet në Kosovë dhe në rajon. "Ka qenë në vazhdimësi ky qëndrim. Këtë e ka shprehur edhe ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, pra është në linjë me deklaratimet e



mëshershme të zyrtarëve të Departamentit të ShBA-së, ku edhe në Beograd kanë thënë që Kosova do të ketë ushtrinë", ka deklaruar kryeministri Haradinaj. Ditë më parë sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka paralajmëruar Kosovën se do të "përballet me pasoja serioze nëse vazhdon transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri të Kosovës". Sipas Stoltenbergut, ky proces po udhëhiqet "në një moment mjaft të papërshtatshëm, pa u respektuar procedurat".

Ndërkaq ambasadori i ri i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë në një intervistë për Radio Televizionin e Kosovës se Uashingtoni ka mbështetur zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe zhvillimin e saj në Forcë të Armatosur. Kosnett ka thënë se, pavarësisht prej shqetësimeve të vendeve fqinje për evoluimin e FSK-në në Forcë të Armatosur, "Kosova ka çdo arsye dhe ka të drejtë të ketë aftësi vetëmbrojtëse". Edhe ish-ambasadori i Holandës në Kosovë, Robert Bosch, ka reaguar ndaj deklaratës së sekretarit të

përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, sipas së cilës, transformimi i FSK-së në ushtri nuk është duke ndodhur në kohën e duhur. "Pajtohemi plotësisht me mikun tim Serwer, pse nuk duhet të ketë ushtri një vend i pavarur? Nuk është kundër askujt (ushtria) dhe është shumetnike, nëse Beogradi nuk do të bënte presion te serbët që të mos bashkohen me të. Dhe sigurisht jo një njësi e UÇK-së që duhet çarmatosur, turp për ju znj. Brnabiq dhe për luftënxitjen nga ana juaj", ka shkruar Bosch në llogarinë e vet në "Facebook".

Studentët, ultimatum Edi Ramës: Ke kohë deri të martën!

TIRANË, 7 DHJETOR - Studentët kanë mbyllur ditën e tretë të protestës para Ministrisë së Arsimit për plotësimin e kërkesave të tyre. Tubimi që pati pjesëmarrje si asnjëherë tjetër në Tiranë u zhvillua në të njëjtën kohë me protestat në qytetet e tjera universitare, Elbasan, Durrës, Shkodër, Korçë etj.

Pas shumë tentativash për negociata, qeveria ende nuk ka plotësuar gjithë kërkesat e studentëve. Ndaj të premtën studentët i kanë dhënë ultimatum Edi



Ramës. Ata kanë deklaruar se Edi Rama dhe qeveria kanë afat deri të martën për t'i përmbushur kërkesat e tyre. Në të kundërt, studentët paralajmërojnë përshkallëzim të protestës.

Gjatë këtyre ditëve studentët do të vijojnë të zhvillojnë protesta. Sot paradite (e shtunë) ata sërish do të mbledhen para Ministrisë së

Arsimit dhe do të protestojnë në mënyrë paqësore. Por, nëse deri të martën qeveria dhe Edi Rama nuk i plotësojnë kërkesat e tyre, protestat do të marrin formë të tjera reagimi.

Basha: Rama, hajdut i pamëshirshëm

TIRANË, 7 DHJETOR - Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka dalë të premtën me një deklaratë për mediet në lidhje me skandalin e falsifikimit të Unazës së Re, ku ka sulmuar kryeministrin, duke e cilësuar hajdut. Basha tha se dokumentet e publikuara në media treguan vjedhjen që po bëhej për ndërtimin e Unazës së re. "Kemi dy muaj që e kemi thënë ditë për ditë këtë gjë, megjithëse helmimi nga gënjeshtat e qeverisë ka penguar shumë qytetarë ta shohin të vërtetën, por më mirë vonë sesa kurrë. Sot të gjithë po shohin Ramën si është pa maskë, pa fasadë, hajdut të ftohtë dhe të pamëshirshëm që nuk ndalet para asgjëje. Hajdut që për t'i mbushur xhepat është



gati të flakë në rrugë pleq, femijë, të sëmurë, gra shtatzëna", tha Basha.

Ai kërkoi që Autoriteti Rrugor Shqiptar të dalë para drejtësisë ndërsa, sipas tij, faktet e publikuara i nxorën maskën e

vërtetë kryeministrit Edi Rama. "Ideatori dhe planifikuesi i këtyre zgjedhjeve dhe projekteve të koncesionit dhe çdo vjedhje tjetër është Rama. Ai ka vetëm një gjë si moral: paranë. Para parave për të s'ka vlerë asgjë, as e ardhmja, as të rinjtë. Edi Rama as nuk ka pasur dhe nuk ka as vullnet, as vizion dhe plan për të punuar për njerëzit. Për të qeverisje do të thotë vjedhje. Vjedhja është qëllimi dhe përmbajtja e qeverisë së sotme, gjithçka tjetër është propagandë", tha Basha.

Gjykata Speciale fton për intervistim komandant 'Remin'

Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) për rajonin e Llapit, Rustem Mustafa-"Remi", është ftuar për intervistim nga zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës në Hagë. Ai më 14 janar të vitit të ardhshëm do të paraqitet pranë Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës (ZPS) në Hagë. Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) dhe ish-komandanti i UÇK-së, Zafir Berisha, këtë veprim të Speciales e kanë vlerësuar të padrejtë. Ata janë shprehur krenarë me luftën çlirimtare

vazhdimisht organizoi komplete kundër luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Edhe në rastin e zhvillimit të hetimeve nga Gjykata Speciale, ndaj komandant 'Remit'-Rrustem Mustafës dhe të tjerëve, konsiderojmë se është duke u bërë padrejtësi për shkak se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka bërë luftë çlirimtare mbrojtëse në pajtim me konventat ndërkombëtare", është thënë në reagimin e OVLUÇK-së, duke shtuar se nuk janë kundër drejtësisë, por kundër kësaj gjykate. "Ne si OVLUÇK e kemi thënë se nuk jemi kundër drejtësisë dhe për këtë kemi kërkuar gjykatë vendore që i ndjek krimet, por kemi qenë dhe jemi kundër Gjykatës Speciale për shkak se është një-etnike dhe nuk ka për qëllim ndjekjen e atyre që kanë kryer krime, por vetëm komprometimin e luftës sonë çlirimtare", është thënë në reagimin e OVLUÇK-së. Në mbrojtje të komandant "Remit" ka dalë edhe ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), aktualisht

deputet i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha. Ai ka thënë se Kosova duhet të krenohet me luftën për liri që ka bërë UÇK-ja, përfshirë këtu edhe komandant "Remin". Sipas tij, Gjykata Speciale do t'i ndjekë ata që luftuan për liri e jo ata që bënë gjenocid në Kosovë. "Kosova duhet të krenohet me luftën për liri që ka bërë UÇK-ja, përfshirë këtu edhe komandant 'Remin'. Rrustem Mustafa-'Remi' dhe luftëtarët e lirisë duhet të ndihen të fyer nga Hashim Thaçi së pari dhe ata që me vota krijuan hapësirë që të krijohet kjo gjykatë, e cila do t'i ndjekë ata që luftuan për liri e jo ata që bënë gjenocid në Kosovë", ka shkruar Berisha në llogarinë e vet në "Facebook". Arianit Koci, avokati i "Remit", ka njoftuar të enjten në mbrëmje se klienti i tij vullnetarisht do të paraqitet më 14 janar të vitit të kaluar në Hagë. Ai ka thënë se ende nuk dihet se në çfarë cilësie është i ftuar klienti i tij nga kjo gjykatë. "Me autorizimin e klientit tim, z. Rrustem Mustafa, ju

njoftoj se z. Mustafa ka pranuar një ftesë që më datën 14 janar 2019 të paraqitet pranë Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës (ZPS) në Hagë. Kjo është ftesë për intervistim. Z. Mustafa do të paraqitet vullnetarisht dhe është i gatshëm të sqarojë çdo rrethanë të cilën ZPS-ja është duke e hetuar. Kjo është e gjitha për çfarë kemi njohuri tani për tani, dhe me mirësjellje kërkoj nga gazetarët të mos e kontaktojnë z. Mustafa rreth kësaj çështjeje", ka deklaruar Koci nëpërmjet një komunikate për medie. Dhomat e Specializuara të Kosovës janë funksionalizuar plotësisht më 5 korrik të vitit 2017, kur ishte miratuar dokumenti për zhvillimin e procedurës penale, Rregullorja e Procedurave dhe Provave. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar punojnë për hetimin e krimeve kundër njerëzimit, krimeve të luftës dhe veprave të tjera penale në lidhje me akuzat nga Raporti i Këshillit të Evropës i vitit 2011.

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË 7 DHJETOR - Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) për rajonin e Llapit, Rustem Mustafa-"Remi", është personi i parë që do të intervistohet nga Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës (ZPS) në Hagë. Njoftimi i avokatit, Aranit Koci, për këtë ftesë ka nxitur reagime të shumta në Kosovë, duke e vlerësuar këtë si një padrejtësi që po i bëhet luftës së UÇK-së. Kryesia e Organizatës së

Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka reaguar ndaj ftesës së Gjykatës Speciale për intervistimin e ish-komandantit të Zonës Operative të Llapit, Rustem Mustafa-"Remi". Sipas kësaj organizate, edhe në rastin e "Remit" drejtësia ndërkombëtare është duke bërë padrejtësi ndaj UÇK-së, e cila ka bërë luftë çlirimtare. "Për shumë vjet pas luftës ishim dëshmitarë të dështimit total të drejtësisë ndërkombëtare, e cila nëpërmjet mekanizmave të ashtuquajtur të drejtësisë,



Transferohen mjetet në llogaritë e 647 personave që kanë qenë të angazhuar në zgjedhjet lokale

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se është dërguar lista për pagesë e pjesës së fundit të stafit zgjedhor të angazhuar në

procesin zgjedhor të vitit të kaluar. "Transferimi i mjeteve është bërë në llogaritë aktive të 647 personave të cilët kanë qenë të angazhuar në zgjedhje si: komisionarë, personeli

për raportimin e rezultateve preliminare (K-Vote) dhe në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Duke pasur parasysh se zgjedhjet lokale janë mbajtur në

fund të vitit të kaluar, disa pagesa për trupat zgjedhore nuk ishte e mundur të realizoheshin brenda vitit 2017", është thënë në njoftimin e KQZ-së.



Flet për "Epokën e re", Ramadan Qehaja

Pas mbështetjes së ShBA-së nuk du



Njohësi i çështjeve ushtarake dhe të sigurisë, Ramadan Qehaja, ka vlerësuar se reagimi i NATO-s nuk mund ta ndërpresë rrugën për formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Ai ka thënë se nuk do të ketë zbrapsje në këtë drejtim sepse Kosova është shtet i pavarur dhe i merr vetë vendimet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Qehaja ka thënë se pas mbështetjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) Kosova nuk duhet të ketë hamendje për formimin e ushtrisë. Megjithatë, ai ka thënë se pavarësisht prej ftohjeve që mund të kenë në këtë periudhë marrëdhëniet në mes të FSK-së dhe NATO-s, në një të ardhme jo të largët situata do të kthehet në normalitet, do të vazhdojë bashkëpunimi i ndërsjellë dhe Kosova do të bëhet pjesë e NATO-s

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 7 DHJETOR -

"Epoka e re": Z. Qehaja, si i keni parë reagimet e NATO-s sa i përket transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës?

Qehaja: Kemi një vonesë shumë të madhe për ngritjen e kapaciteteve të Forcës sonë të armatosur dhe për këtë ka shumë shkaqe. Është e habitshme se si për katër vjet të tenta-

tivës sonë nuk kemi arritur ta formojmë Forcën e Armatosur të Kosovës. Personalisht e kam pritur reagimin e NATO-s lidhur me këtë çështje sepse fjala është për Forcën e Sigurisë së Kosovës e cila po e merr një rol të veçantë, pra po merr attribute ushtarake në kryerjen e detyrave të veta. Që 19 vjet merremi me shuarje të zjarreve dhe me mbrojtje civile, po asses nuk kemi mundur që si faktor vendor të ecim përpara dhe t'i kemi Forcat e Armatosura

Më 17 dhjetor nis procesi i legalizimit të armëve

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) të premtën është mbajtur takim i grupit punues për rishikimin e planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Armët e Vogla dhe të Lehta dhe planit të veprimit të Udhërrëfyesit Rajonal për Armë të Vogla dhe të Lehta. Ky takim është drejtuar nga Koordinator

Kombëtar për Armë të Vogla dhe të Lehta, Izmi Zeka, i cili mban edhe detyrën e zëvendësministrit të Punëve të Brendshme. Në takim grupi punues ka prezantuar planin e rishikuar dhe i njëjti është aprovuar për t'u proceduar pas-taj për nënshkrim nga ministri i MPB-së. Po në këtë takim është diskutuar edhe për përgatitjet dhe prezantimin e prioriteteve

në takimin e nivelit të lartë ndërministror që do të mbahet në Paris më 11 dhjetor 2018, ku Republika e Kosovës do të paraqesë një numër të projekteve për aprovim nga donatorët. Po ashtu, zëvendësministri Zeka ka folur edhe për përgatitjet e bëra për zbatimin e procesit të legalizimit të armëve që do të fillojë më 17 dhjetor të këtij viti.



het të kemi hamendje për ushtrinë



tutje, të bashkëpunojmë me NATO-na dhe në një kohë jo të largët të jemi anëtarë të NATO-s.

"Epoka e re": Nuk ka rrezik që ky kundërshtim i NATO-s ta zbrapsë Kosovën për formimin e ushtrisë?

Qehaja: Reagimi i NATO-s nuk mund të na ndërpresë rrugën tonë për formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Nuk mund të ketë zbrapsje. Nuk na interesojnë vlerësimet e Serbisë zyrtare dhe të disa shteteve anëtare të NATO-s lidhur me transformimin e FSK-së, sepse ne jemi shtet sovran dhe vendimet i marrim vetë. Ne duhet të avancojmë FSK-në asisoj që ajo të jetë e përgatitur për detyra të vetëmbrojtjes dhe assesit për detyra destabilizuese ashtu siç po trumbeton Beogradi zyrtar, sepse kjo nuk është e vërtetë. Me një numër kaq të vogël të pjesëtarëve të FSK-së ta destabilizojmë rajonin, kjo është e pakuptimtë. Deri më tani FSK-ja ka qenë konsumuese e çështjeve të sigurisë dhe tani dëshiron të jetë kontribuuese e sigurisë edhe në misionet paqësore në botë, nëse ka nevojë.

"Epoka e re": Mund të jenë reagimet e NATO-s vetëm për konsum të jashtëm për shkak të ndikimit serb te disa vende anëtare, apo paralajmërimet e sekretarit të përgjithshëm të kësaj organizate se Kosova do të ballafaqohet me pasojat nëse e transformon FSK-në?

Qehaja: Kjo pyetje nuk është e lehtë dhe nuk dua të hyj në çështjet që po i shtroni. Pasoja që i ka përmendur sekretari i NATO-s do të ketë ftohje të marrëdhënies në relacionet e FSK-së dhe të Kosovës me NATO-n apo KFOR-in në Kosovë. Mirëpo me kalimin e kohës, për shkak të detyrave që ne do t'i kryejmë në vetëmbrojtje dhe përgatitjet që duhet t'i bëjë çdo shtet për mbrojtjen vetjake, atëherë çështja do të vijë në suaza normale dhe një bashkëpunim i mirë do të ndodhë në një të ardhme jo të largët në mes të FSK-së dhe NATO-s.

"Epoka e re": Duhet frikësuar paralajmërimet të NATO-s, se do ta shqyrtojë bashkëpunimin me FSK-në, duke pasur parasysh se Kosova synon të bëhet pjesë e NATO-s?

Qehaja: Nuk e besoj se do të ndodhë kjo. Edhe pse paralajmërimet janë dhe duhet t'i marrim si të tilla, por duhet të jemi të vëmendshëm dhe të shpjegojmë se çfarë jemi duke ndërmarrë. Sepse diplomacia dhe politika destruktive serbe e ka bërë të vetën dhe Serbia ka një rol në kuadër të Bashkimit Evropian, mirëpo edhe pse nuk është anëtare e NATO-s, nuk do të thotë se kjo organizatë nuk e shikon me një sy si shtet që ka një pozitë të rëndësishme gjeostrategjike. Prandaj ne me punën tonë duhet të tregojmë se FSK-ja do të jetë për vetëmbrojtje dhe assesit për çështje të tjera siç po trumbeton Beogradi.

"Epoka e re": Pavarësisht prej kundërshtimeve të NATO-s dhe të Serbisë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë dalë në mbështetje të transformimit të FSK-së, duke e parë këtë si hap të natyrshëm dhe të rëndësishëm.

Qehaja: Shtetet e Bashkuara të Amerikës deri në gjysmën e këtij viti kanë qenë konsekuente për të na stopuar në këtë rrugëtim për shkaqe politike dhe diplomatike dhe ne e kemi marrë këtë për bazë. Mirëpo, kur ShBA-ja ka vlerësuar se Kosova i ka ndërmarrë të gjitha masat sa i përket shpjegimit të këtyre çështjeve mbrojtëse për minoritetin serb këtu në Kosovë, si dhe u ka shpjeguar diplomatëve se çfarë po dëshiron të bëjë si shtet i pavarur dhe sovran, atëherë ShBA-ja ka nxjerrë përfundimin se Kosova duhet t'i formojë Forcat e Armatosura, përkatësisht ngritjen e gatishmërisë vepruese ushtarake të FSK-së nëpërmjet ligjeve dhe jo nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese sepse pengesa kryesore ka qenë Beogradi zyrtar nëpërmjet Listës Serbe.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh mbështetjen e Amerikës, mund të llogarisim se nuk do të ketë pengesa dhe ndalesa të tjera në këtë proces?

Qehaja: Pavarësisht prej kundër-

shtimeve anësore që kanë thënë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, se Kosova duhet t'i formojë Forcat e Armatosura të Kosovës, këtu nuk ka më dilemë. Kur një superfuqi siç është Amerika e thotë këtë nuk kemi pse të hamendemi. Mund të mos 'përlehemi' apo t'i 'prishim' marrëdhëniet diplomatike me shtetet që po e kundërshtojnë këtë proces, por duhet të ecim tutje pavarësisht prej kundërshtimeve.

"Epoka e re": Z. Qehaja, dmth., më 14 dhjetor do të miratohen ligjet dhe Kosova do të bëhet me ushtri?

Qehaja: Jam shumë optimist se më 14 dhjetor do të miratohen tri projektligjet nëpërmjet të cilëve do të bëhet transformimi i FSK-së, sepse spektri politik, përveç Listës Serbe, është i përgatitur ta bëjë këtë. Jam i befusuar me qëndrimet e disa politikanëve dhe analistëve të cilët në këtë situatë e kundërshtojnë këtë çështje. Nëse marrim një vendim si shtet, qoftë ai edhe i gabuar, duhet të ecim përpara, prandaj nuk duhet të ketë kundërshtime për këtë mënyrë të transformimit të FSK-së. Të gjithë ata që e kundërshtojnë këtë nuk ia duan të mirën shtetit dhe shtyllës kryesore të shtetit sovran, siç është shtylla ushtarake dhe e sigurisë. Këto janë shqetësime të disa individëve destruktivë. Na duhet një deçenie derisa t'i marrim 'këmbët', pra që të bëjmë plane afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata. Ky proces nuk është i lehtë dhe ka shumë punë për t'u bërë, mirëpo ne duhet të ecim tutje. I kemi njerëzit e shkolluar në akademitë më të prestigjioze në botë të cilët duhet të vihen në pozita adekuate për t'i kryer punët më të vështira që kanë të bëjnë me procesin e formimit të Forcave të Armatosura të Kosovës. Prandaj këtë fundvit duhet të jemi më të lumtur sepse po e kryejmë një punë shumë të rëndësishme e cila na ka mbetur zvarrë. Sepse të mbetesh duke u marrë vetëm me çështje të mbrojtjes civile dhe gatishmërisë emergjente si shtet sovran ka qenë e pabesueshme. Mirëpo ja që erdhi ky çast, që edhe Kosova, sikur çdo shtet i rajonit, ta ketë ushtrinë e vet, përkatësisht FSK-në me një gatishmëri ushtarake dhe luftarake për vetëmbrojtje.

të Kosovës. Tash ka ardhur një çast shumë i rëndësishëm, pavarësisht se disa thonë se kryeministri këtë iniciativë e ka marrë për atë apo për këtë shkak. Konsideroj se transformimi i FSK-së nëpërmjet ligjit është një hap shumë pozitiv. Në kuadër të NATO-s ka shtete të cilat nuk e kanë e njohur Kosovën dhe në këtë kontekst edhe diplomacia shumë e ashpër serbe e ka bërë të veten që këto shtete t'i përgatitë për të dhënë një rezistencë

shumë të madhe ndaj transformimit të FSK-së deri te tentativa e anulimit të kësaj detyre, por këtë nuk mund ta bëjnë. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, pas kundërshtimeve që i ka përjetuar në takimin e ministrave të shteteve anëtare të NATO-s, domosdoshmërisht është dashur të dalë me një qëndrim mjaft të "fortë", se Kosova nuk duhet t'i formojë Forcat e Armatosura në këtë periudhë. Megjithatë, ne duhet të ecim

Më 10 dhjetor KMDLNj-ja dhe kolegji AAB organizojnë tryezë kushtuar Demaçit

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Më 10 dhjetor, në Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj), së bashku me kolegjin AAB organizon tryezë kushtuar Adem Demaçit, fitues i Çmimit Saharov, dy herë i nominuar për çmimin Nobel për Paqe dhe fitues i shumë çmimeve ndërkombëtare për të

drejtat e njeriut. Ttryeza do të mbahet në Kolegjin AAB dhe fillon në orën 14:00. Panelistë të kësaj tryeze do të jenë: Prof. dr. Hajredin Kuqi, prof. dr. Agim Vinca, rektori i kolegjit AAB, Lulzim Tafa dhe drejtori ekzekutiv i KMDLNj-së, Behxhet Shala. Bashkorganizatorët e kësaj tryeze, kolegji AAB dhe KMDLNj-ja, vlerësojnë se nuk

ka aktivitete më të qëlluara për shënimin e 60-vjetorit të miratimit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara se përkujtimi dhe përvetësimi i një simboli që u dha kuptim dhe përmbajtje të drejtave të njeriut në planin kombëtar dhe ndërkombëtar, i unifikuar në figurën dhe personalitetin e Adem Demaçit.




Hiqet lista e pritjes për banderola në AKPPM

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije të premten se lista e pritjes për banderola në Agjencinë Kosovare për Produkte dhe Pajisje Mjekësore (AKPPM) është hequr. Ai ka thënë se asnjë produkt nuk do të mbetet

më nëpër depo të kompanive për një kohë të gjatë dhe, sipas tij, të gjithë qytetarët që kanë nevojë për ato barna do të mund t'i marrin me kohë. "Të gjitha kompanitë të cilat aplikojnë për marrjen e banderolave për barna në AKPPM nuk do të kenë më nevojë të

presin disa muaj, por ato do t'i marrin brenda 24 orëve. Asnjë produkt nuk do të mbetet më nëpër depo të kompanive për një kohë të gjatë dhe të gjithë qytetarët që kanë nevojë për ato barna do të mund t'i marrin ato me kohë", ka deklaruar ministri Ismaili.



Promovohet trilogjia për Skënderbeun nga Avni Dehari

EPOKA ERE Qendresa RAMA

MITROVICË, 7 DHJETOR - Në Qendrën e Kulturës "Rexhep Mitrovica" të premten është bërë promovimi i trilogjisë së librave "Gjergjat në drita përkrenarësh" të autorit Avni Dehari i cili përfshin romanet "Dragoi", "Udhëkryqi" dhe "Flakadanët e lirisë". Të pranishëm me rastin e përvitimit të kësaj trilogjie ishin nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, drejtorë komunalë, asamblistë dhe nxënës të shkollave fillore.

Nënkryetari Mujka e ka vlerësuar lart kontributin e autorit jo vetëm për çështje kombëtare, por edhe për interesimin e tij që gjeneratave të reja t'u ofrojë një pasuri letrare mbi figurën historike të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut i cili duhet të jetë frymëzim për kombin dhe gjen-

eratat e reja.

Autori Avni Dehari është shprehur të jetë i lumtur që sot ndodhet në qytetin e Mitrovicës, ku në mesin e nxënësve, të cilëve edhe u dedikohet ky botim, po bëhet edhe promovimi i kësaj trilogjie. "Unë e kam bërë librin, por një punë shumë të madhe kanë bërë edhe organizatorët e këtij përvitimi që kanë marrë përsipër jo vetëm ta botojnë këtë libër, por edhe ta shpërndajnë në biblioteka, shkolla, madje edhe falas, sepse libri ofrohet për fëmijë dhe të rinj dhe kjo më gëzon më shumë sesa ky libër të ishte shitur me miliona euro", ka thënë autori i trilogjisë "Gjergjat në drita përkrenarësh", Avni Dehari.

Dehari me mjeshtëri të rrallë përshkruan mesjetën shqiptare dhe epokën e heroit tonë kombëtar, ndërsa nxënësit do të kenë mundësi që falas të pajisen me këtë trilogji, është thënë me këtë



rast. "Brezat e tashëm dhe të ardhshëm të lexuesve të të gjitha moshave, veçanërisht fëmijët

dhe të rinjtë, do ta kenë më të afërt, më të gjallë dhe më kumbuese epokën e artë të Gjergj

Kastriotit-Skënderbeut falë kësaj trilogjie", ka thënë redaktori Rushit Ramabaja.

Ministria e Punëve të Brendshme pranon një donacion nga Ambasada e ShBA-së



PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Në një ceremoni rasti ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka pranuar një donacion me pajisje nga Ambasada e ShBA-së, përmes ICITAP/INL. Përveç tri veturave të përdorura, të cilat do t'i ndahen IPK-së, AKF-së, në listën e pajisjeve të dhuruara janë dhjetëra kompjuterë dhe orendi për zyrë.

Qëllimi i dhurimit të këtyre pajisjeve është që t'u ndihmohet agjencive pranuese për operim të përditshëm në terren, krijimi i një laboratorit për mësimin e gjuhës angleze dhe përmirësimin e

ambientit dhe kushteve të tyre të punës. Me këtë rast, ministri Mustafa e falënderoi Ambasadën e ShBA-së për mbështetje të vazhdueshme dhe për kontributin e dhënë për ngritjen e kapaciteteve të organeve ligjzbatuese. Drejtoresha e INL-it për Kosovë, Tracy Whittington, si dhe menaxherja e programit të ICITAP-it/Departamenti i Drejtësisë, Kimberly Riffe, rikonfirmuan vazhdimin e mbështetjes për MPB-në, për përmbushjen e obligimeve të tyre ligjore dhe për ngritjen e nivelit të sigurisë në Kosovë.

Ministri Bytyqi kërkon përkrahjen e Kandasë në fushën e arsimit

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka pritur në takim ambasadorin e Kandasë në Kroaci, njëherësh ambasador jorezident në Kosovë, Daniel Maksymiuk, me të cilin ka

biseduar për zhvillimet në arsim, ër prioritetet dhe mundësitë e bashkëpunimit në këtë sektor.

Ministri Bytyqi fillimisht ka falënderuar ambasadorin Maksymiuk për mbështetjen që Kanadaja i ka dhënë vendit

tonë në çdo aspekt, në veçanti në fushën e arsimit, ndërsa ka theksuar nevojën e thellimit të bashkëpunimit reciprok të institucioneve akademike. Gjatë këtij takimi u bisedua edhe për dygjuhësinë në arsim, për çka ministri

Bytyqi e informoi ambasadorin se në Kosovë ofrohet arsimim në të gjitha gjuhët e komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Ministri Bytyqi dhe ambasadori Maksymiuk u pajtuan që sa më parë të fillohet



bashkëpunimi me projekte konkrete në fushën e edukimit.

Kërkohet profilizimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve për prokurimin publik

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) nëpërmjet një tryeze diskutimi ka shpalosur të premtën punimin e shkurtër rreth politikave "Integriteti, elementi kyç në përmirësimin e prokurimit publik", që ilustron politikat aktuale në menaxhimin e parasë publike nëpërmjet prokurimit publik, problemet me të cilat ballafaqohet ky proces, mbi të gjitha adreson nevojën e rritjes së integritetit në këtë sektor. Bazamenti i këtij punimi buron nga punësoria e përbashkët me përfaqësues të institucioneve qeveritare, të drejtësisë, shoqërisë civile dhe mediat, por edhe nga praktikantët e mira ndërkombëtare të cilat kanë prodhuar rezultate për ngritjen e integritetit institu-

cional. Me këtë rast, Arben Kelmendi, menaxher i programit Kundër Korrupsionit të KDI-së, ka thënë se vetëm gjatë vitit 2017 në Kosovë janë zhvilluar 10 214 aktivitete të prokurimit nga 163 autoritete kontraktuese. Vlera e këtyre prokurimeve, duke përfshirë edhe pjesën e alokuar për vitin 2017, për ndërtimin e autostradës "Arbër Xhaferi", është 641,298,561.48 euro apo 35 për qind të buxhetit të alokuar për të njëjtin vit (1,810,131,478.00 euro). "Kjo përqindje tregon se prokurimi publik përbën një nga veprimtaritë kryesore në shpenzimin e parasë publike. Më tutje, ai shtoi se prokurimi publik në Kosovë vazhdon të mbetet i ndjeshëm ndaj korrupsionit pavarësisht prej përparimit të bërë në vitet e fundit për adresimin e këtij fenomeni. Sipas raporteve të ndryshme


ndërkombëtare, ligjet janë ndryshuar disa herë dhe ato janë në përputhshmëri me acquis të BE-së", ka thënë ai. Ndërsa Arton Demhasaj, drejtor ekzekutiv i organizatës "Çohu", ka theksuar se nevoja për profilizim të prokurorëve dhe gjyqtarëve për prokurim publik është e evidente, po ashtu ka shtuar se ka nevojë për ngritje të resurseve njerëzore, respektivisht ekspertë të fushës së prokurimit si staf ndihmës për gjyqësorin. "Zbatimi i normës së kodit penal që merret me shkeljet në fushën e prokurimit publik do të ndikonte në përmirësim të fushës së prokurimit në mënyrë që të jetë më transparente dhe të ketë më pak shkelje në këtë fushë", ka thënë Demhasaj. Kurse Diana Metushi-Krasniqi nga KDI-ja ka thënë se, edhe pse Kosova ka disa nivele të

llogaridhënies në menaxhimin e financave publike, raportet e ndryshme ndërkombëtare dhe ato të shoqërisë civile dhe mediave në Kosovë tregojnë për dhënie të tenderëve miqve dhe anëtarëve të familjes së politikanëve në pushtet, ose të zyrtarëve të prokurimit, mosrespektim të ligjit nga autoritetet kontraktuese, transparencë të kufizuar, manipulim të ofertave, menaxhim të dobët të kontratave, rregullim të çmimeve pas dhënies së kontratave, presion politik, kapje të shtetit, probleme me platformën elektronike të prokurimit dhe mosndëshkim të vazhdueshëm për shumë nga këto shkelje dhe parregullsi. Meqë këto probleme janë të ndërlidhura ngushtë me faktorin njeri, ajo ka pohuar se është esencial fuqizimi i integritetit dhe llogaridhënies në këtë sektor të

rëndësishëm për shpenzimin e parasë së tatimpaguesit. "Integriteti, elementi kyç në përmirësimin e prokurimit publik" konkludon se fokusimi në forcimin e integritetit në prokurimin publik është thelbësor për t'i dhënë fund kësaj gjendjeje. KDI-ja rekomandon të procedohet themelimi i Byrosë së Integritetit brenda Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. Byroja e Integritetit të Prokurimit Publik do të funksiononte si një qendër kombëtare e ekspertizës dhe do t'i mbështeste autoritetet kontraktuese për zbatimin dhe kontrollin e përgjegjësive të tyre në fushën e integritetit dhe në promovimin e tij si vlerë fundamentale e qeverisjes së mirë. Ky projekt është mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS.



Haradinaj: Angazhimi i ri i EULEX-it ndihmon forcimin e institucioneve të Kosovës



PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të premtën në takim drejtorin e Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian për planifikim civil dhe aftësi të sigurisë (EEAS), Vincenzo Coppola. Kryeministri Haradinaj e ka uruar drejtorin Coppola për marrjen e detyrës dhe për ardhjen e tij për të shërbyer në Republikën e Kosovës. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka thënë se mirëpret bashkëpunimin që institucionet tona e kanë me ato të misionit të EULEX-it dhe se mandati i ri do

të ndihmojë që t'i forcojë kapacitetet e tyre. "E mbështes angazhimin e ri të EULEX-it në rolin e tij që t'i forcojë institucionet tona. Pothuajse të gjitha lëndët janë transferuar nga EULEX-i në institucionet e Republikës së Kosovës, ndërsa sa i përket sundimit të ligjit, ne e kemi rritur buxhetin për drejtësinë, pagat për gjyqtarët, prokurorët dhe policinë dhe më e rëndësishmja kemi çuar përpara ligjet e nevojshme për ta përmirësuar sistemin gjyqësor në vend", ka deklaruar Haradinaj. Kryeministri ka theksuar se

pakoja e ligjeve të antikorrupsionit është miratuar në parlament dhe se në rrugë janë edhe ligje të tjera të rëndësishme në fushën e sundimit të rendit dhe ligjit. Po gjatë takimit është diskutuar edhe për Dhomat e Specializuara si dhe për çështje të tjera të rëndësishme për vendin. Ndërkaq drejtori Coppola ka vlerësuar lart angazhimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ta çuar përpara agjendën legislative të vendit, duke treguar gatishmërinë për ta vazhduar bashkëpunimin e dyanshëm.



Ministri Lluka në Slloveni për ta rritur bashkëpunimin ekonomik

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Investimet qindramilionëshe ishin temat e diskutimit gjatë takimeve që ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, zhvilloi me investitorë potencialë, ministra dhe përfaqësues të bizneseve gjatë vizitës zyrtare Slloveni.

Kreu i MZHE-së, Valdrin Lluka, po qëndron në qytetin e Lubjanës, ku po mban takime të ndryshme për t'i shikuar mundësitë e investimeve në fushën e ujërave, mbeturinave, energjisë dhe agrobiznesit. Gjatë takimit me menaxhmentin e bankës shtetërore eksportuese të Sllovenisë, SID BANK, Lluka ka diskutuar futjen e kapitalit slloven në Kosovë në fushën e ujërave,

energjisë, mbeturinave dhe agrobiznesit. SID Bank ka aprovuar kërkesën për financimin e investimeve në vlerë prej rreth 200 milionë eurosh në fushën e ujërave dhe agrobiznesit, si dhe është e gatshme edhe për projekte të tjera në fushën e ambientit, siç janë trajtimi i ujërave të zeza për komuna deri në 30 000 banorë.

Ministri Lluka është takuar edhe me stafin menaxhues të kompanisë InterEnergjo e cila ka investuar rreth 60 milionë euro në Kosovë, duke ndërtuar katër hidrocentrale të cilat janë aktive dhe prodhojnë rreth 35 mwh energji elektrike. Kjo kompani ka shprehur

interesimin edhe për zgjerim pasi, sipas drejtorit të përgjithshëm Anton Papez, janë të kënaqur me shërbimin dhe trajtimin që po ju bëhet në Kosovë.

Në takimin me ministrin e Zhvillimit Ekonomik dhe Teknologjisë, Zdravko Pocivalsek, ministri Lluka e njoftoi homologun e tij rreth potencialeve që ofron Kosova, me fokus në sektorin energjetik ku pritet të investohen rreth tre miliardë euro në 10 vjetet e ardhshëm, ashtu siç parashihet me Strategjinë për energji që është aprovuar këtë vit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Për më tepër, ministri Lluka paraqiti edhe potencialet në

sektorin e ujërave, në veçanti menaxhimin e ujërave siç janë krijimi i rezervuarve, trajtimi i ujërave të zeza dhe instalimi i orëmatësve digjitalë. Gjithashtu, ministrat u pajtuan që një delegacion me biznese nga Sllovenia, që kanë fokus industrinë e energjisë, minierave dhe ujërave, të shoqëruar me Pocivalsek, të vizitojnë Kosovën dhe t'i shohin këto potenciale nga afër.

Në kuadër të këtij delegacioni ishte edhe ministri i Bujqësisë, Shukri Maxhuni, ku së bashku me ministrin Lluka takuan sekretaren e Shtetit të Ministrisë së Bujqësisë, Tanja Strnisa, me të cilën diskutuan rreth platformës agrare e cila ka për

qëllim angazhimin e të gjithë fermerëve në Kosovë, të cilët prodhojnë produkte bazë ushqimore se do të kenë shitje të garantuar nga një sistem i organizuar që merret me përpunimin, asortimin, paketimin dhe shitjen e produkteve, duke u krijuar mundësi fermerëve individualë të zhvillohen përmes qasjes në financa nga po i njëjti mekanizëm. Platforma agrare është bazë për zhvillim të mirëfilltë të sektorit të bujqësisë. Ministri Lluka përfundoi vizitën duke vizituar fabrikën Iskra Emeco, ku u prit nga ekzekutivi dhe pronari i kësaj kompanie, Ahmed Elsewedy, kryeshefi Luis Goncalves dhe anëtarë i bordit, Dieter Brunner.

Investitorët kanadezë të interesuar për sektorin mineral të Kosovës

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka pritur të premtën në takim ambasadorin e Kanadasë, jorezident në Kosovë, Daniel Maksymiuk, me të cilin ka diskutuar për thellimin e bashkëpunimit dhe për zhvillimet në vend.

Ministri Shala e ka njoftuar ambasadorin Maksymiuk për prioritetet që i ka MTI-ja dhe për mundësinë që shteti kanadez të investojë në Kosovë në fushën e minierave dhe mineraleve. "Është nder dhe kënaqësi t'ju pres në takim, sepse Kosova e konsideron më shumë se shtet mik Kanadanë. Po vazhdoj përmblidhjen e planeve që i ka Qeveria e Kosovës, që janë të parapara për këtë vit, njëkohësisht duke e rritur dinamikën në secilën fushë. Brenda këtij resori i kam identifikuar prioritetet e mia të cilat mendoj të fokusohem më shumë e që janë mbrojtja e konsumatorit, thithja e investimeve

tëhuaja, sepse ministria që drejtojnë unë implementon edhe Ligjin për Investime Strategjike dhe përmirësimi i cilësisë së produkteve të cilat u ofrohen në treg qytetarëve tanë. Po ashtu, fokus kam përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe përkrahjen prodhuesve vendorë dhe promovimin e eksportit", ka theksuar ministri Shala.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për mundësitë e investimeve kanadeze në sektorin e minierave, që ambasadori Maksymiuk shprehu gatishmërinë e bizneseve të këtij shteti të investojnë në Kosovë për zhvillimin e ekonomik të Kosovës.

Ministri Shala ka kërkuar nga ambasadori që t'i inkurajojë bizneset kanadeze të investojnë në Kosovë duke shprehur gatishmëri për mbështetje të plotë, duke treguar përkushtimin e çdo institucioni që të jetë avokat i bizneseve që shprehin vullnet për të investuar.



Haradinaj kërkon nga KEK-u të prodhojë rrymë



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, të premten ka vizituar Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), ku është pritur nga drejtori menaxhues i saj, Njazi Thaçi. Kryeministri ka thënë se KEK-u është kompani vendore dhe duhet të jetë kujdestare që të ketë rrymë

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 7 DHJETOR - "Kërkesa ime për drejtorin dhe për kolegët e tjerë është që të lëshojnë në prodhim çdo bllok të mundshëm dhe të luftohet për çdo megavat të vendit", kështu ka thënë të premten kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, gjatë vizitës që i ka bërë Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), ku është pritur nga drejtori menax-

hues i saj, Njazi Thaçi me bashkëpunëtorë. Fillimisht kryeministri Haradinaj ka vizituar Termocentralin 'Kosova A', ku është njoftuar për gjendjen e përgjithshme në KEK dhe për prodhimin e energjisë. Më pas kryeministri Haradinaj ka vizituar Termocentralin 'Kosova B', ku ka zhvilluar një takim pune me drejtorët ekzekutivë të KEK-ut. Pas vizitave, kryeministri Haradinaj para medieve të pranishme ka deklaruar se qëllimi i

ardhjes së tij në KEK është për ta parë nga afër se si është puna me bloqet, sa janë në funksion, sa janë në remont, si është dinamika e lëshimit në prodhim të bloqeve të tjera. "U njoftova se edhe në 'Kosovën A' pritet së shpejti të lëshohet një bllok, ndoshta të hënën, por edhe në 'Kosovën B' pritet të lëshohet blloku tjetër për prodhim", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke thënë se aktualisht janë në prodhim rreth 530 megavatë për konsumatorë, që i bie se rreth 400 megavatë të tjerë duhen siguruar nga importi. Duke folur rreth importit të energjisë, kryeministri Haradinaj tha se importi i ka dy të këqija, e keqja është se është import, pra është mall që nuk është prodhuar në Kosovë dhe e prish bilancin

tregtar dhe shkakton pasoja për ne si Kosovë, por edhe se tani në dimër importi i energjisë është shumë i shtrenjtë.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se i është premtuar se nga 15 dhjetori do të prodhohen rreth 800 megavatë nga KEK-u, në të njëjtën kohë kryeministri ka shtuar se duhet të bëhet kujdes që edhe gjatë këtij dimri të mbijetohet prodhimi.

Kryeministri Haradinaj ka folur edhe rreth KEDS-it, duke thënë se kjo kompani është e Kosovës, por që investitori është i huaji dhe ka ardhur për të bërë biznes, për t'i fituar paratë e veta, por ka obligime ndaj konsumatorit dhe ndaj nesh, në anën tjetër kryeministri Haradinaj ka thënë se KEK-u është kompani vendore dhe

duhet të jetë kujdestare që të ketë rrymë.

Në fund të fjalës së tij kryeministri Haradinaj ka vlerësuar se gjatë këtij dimri nuk bën të dështojnë, duke thënë se edhe viti i kaluar ka qenë tepër sfidues, se s'ka pasur qymyr dhe ekskavatorët nuk kanë qenë në funksion.

Drejtori menaxhues i KEK-ut, Njazi Thaçi, pasi ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për vizitën dhe kujdesin që ka treguar ndaj Korporatës Energjetike të Kosovës, ka thënë se e ka njoftuar kryeministrin për aktivitetet që janë duke zhvilluar si Korporatë Energjetike, për prodhimin aktual që kanë, po dhe për problemet dhe planifikimet si dhe për masat që i kanë ndërmarrë që këtë dimër ta kalojnë sa më mirë.

Paralajmërohen masa për rritjen e sigurisë në banka

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Me ftesë të guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, është mbajtur takimi me ministrin e Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, drejtorin e

Departamentit të Hetimeve të Policisë së Kosovës, Riza Shillova, anëtarin e Bordit të Shoqatës së Bankave, Orcun Ozdemir, dhe drejtorin ekzekutiv të Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit

Balijs. Në këtë takim u diskutua për shqetësimet rreth dukurisë së plaçkitjes së bankave në Kosovë. Të gjithë përfaqësuesit e institucioneve pjesëmarrëse në këtë takim shprehën gatishmërinë për t'i

ndërmarrë masat e nevojshme, me qëllim të rritjes së nivelit të sigurisë në sektorin bankar dhe u pajtuan që ta rrisin bashkëpunimin ndërinstitucional për t'i adresuar këto sfida.



Kamenica, e dyta në Kosovë me platformë digjitale

KAMENICË, 7 DHJETOR (ER) - Komuna e Kamenicës së shpejti do ta fillojë së zbatuari platformën online "Kamenica Open Data", si komuna e dytë në Kosovë pas Prishtinës, por e para për këtë platformë në Android dhe IOS.

Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, së bashku me drejtorin ekzekutiv të organizatës General Youth Education of Kosovo (GYEK), Alutrim Dërmaku, patën një takim informues rreth kësaj platforme që do të fillojë së zbatuari së shpejti edhe në Kamenicë. Nëpërmjet kësaj platforme "Kamenica Open

Data" do të bëhet pasqyrimi i të gjitha informacioneve të mbledhura nga drejtoritë komunale dhe do të bëhet klasifikimi në disa kategori, ku do të përfshihet edhe puna e kryetarit të komunës. "Përmes transparencës dhe qasjes së lehtë në shërbime komunale do të përqipemi shumë që ta kthejmë besimin e qytetarëve në institucione publike", ka thënë kryetari Kastrati.

Ky projekt është financuar nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe do të zbatohet nga Komuna e Kamenicës dhe organizata GYEK.



Haskuka premtion mbështetje për Universitetin 'Ukshin Hoti'

PRIZREN, 7 DHJETOR (ER) - Me ftesë të dekanit të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit të Universitetit "Ukshin Hoti", Isuf Lushi, kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka, ka vizituar këtë universitet. Gjatë kësaj vizite është diskutuar për mundësinë dhe nevojën e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve, me theks të veçantë sigurimi i një hapësire komunale për vendosjen e kopshtit botanik që do të shërbejë

për nevoja të këtij fakulteti që është edhe kusht për riakreditim.

Dekani i këtij universiteti ka falënderuar kryetarin Haskuka për gatishmërinë që ka treguar për mbështetjen e UPZ-së. Ai ka kërkuar të konkretizohet bashkëpunimi në mes të Komunës së Prizrenit dhe UPZ-së. Ndërsa kryetari i Prizrenit, Mytahir Haskuka, ka theksuar se janë disa fusha ku mund të shtrihet bashkëpunimi në mes

të kësaj komune dhe Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit. Ai ka shprehur gatishmërinë për t'i shqyrtuar mundësitë që ka komuna për ta ndihmuar UPZ-në për gjetjen e një lokacioni të përshtatshëm për vendosjen e kopshtit botanik. Në fund të takimit palët kanë rënë dakord t'i konkretizojnë fushat e bashkëpunimit dhe në të ardhmen të nënshkruhet një memorandum për bashkëpunim.



Elezaj, vizitë zyrtare në Zvicër për shkëmbim të përvojave

KLINË, 7 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Lorenc Marleku, dhe drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Skënder Mërturi, janë duke qëndruar për vizitë zyrtare në Zvicër. Me këtë rast, në ditën e parë të kësaj vizite, kryetari Elezaj dhe drejtorët kanë vizituar Komunën e Nottwilit, ku janë pritur nga kryetari i kësaj komune, Walter

Steffen.

Delegacioni nga Klina është njoftuar me të gjitha shtyllat e formës së organizimit të kësaj komune, po ashtu edhe për mundësinë e bashkëpunimit në mes të Komunës së Nottwilit me Komunën e Klinës në disa fusha të jetës. Me këtë rast, delegacioni nga Klina ka shfrytëzuar mundësitë e takimeve në shumë fusha, duke u nisur nga fusha e arsimit, e ka vizituar shkollën e kësaj komune ku

mësimet i vijonin edhe nxënësit shqiptarë.

Një vizitë është realizuar edhe në organizatën e menaxhimit të mbeturinave, me ç'rast kryetari Elezaj dhe drejtorët janë njohur me një sistem interesant të menaxhimit të mbeturinave dhe riciklimit të tyre. Elezaj me stafin e vet ka vazhduar agjendën duke vizituar palestrat sportive, gjithashtu edhe hapësirat e tjera në lëmenjtë e kulturës.

Haliti kërkon përfundimin e projekteve në fushën e ujit të pijshëm

VITI, 7 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, ka pritur të premtion në takim përfaqësues nga DORSCH/CDI dhe K.R.U "Hidromorava". Gjatë këtij takimi është folur rreth memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar në mes të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Kosovës dhe Programit RWSSP - Faza e VI. Kryetari Haliti ka shtruar nevojën e kësaj komune që sa më parë të përfundojnë projektet në fushën e sigurimit të ujit të pijshëm në lokalitetet e ndryshme të kësaj komune, duke potencuar se pas përfundimit ato duhet të merren nën menaxhimin e kompanisë regjionale të ujërave "Hidromorava".

Gjithashtu, është biseduar rreth sigurimit të ujit të pijshëm për fshatrat: Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Poshtme, Sadovinë e Jerlive, Sadovinë e Çerkezëve dhe Trestenik. Në këtë takim, përpos që është biseduar për fazat 4, 5 dhe 6 të këtyre projekteve, pjesëmarrësit kanë bërë me dije se është biseduar edhe për gypin e ujësjellësit të Letnicës si dhe për rrjetet e ujësjellësit për fshatrat: Smirë, Vërban, Stubëll, Letnicë dhe Debelldeh.



Reforma në drejtësi, nevojë e kohës, apo temë për konsum politik



Berat PEÇI, avokat

Se është i brishtë sistemi i drejtësisë te ne tashmë është thënë shumë herë, edhe nga monitoruesit e institucioneve të drejtësisë, shoqëria civile, por edhe shumë organizata serioze që merren me publikimin e raporteve nga kjo fushë. Tashmë pothuajse janë bërë rutinë skandalet në sistemin e drejtësisë tonë, duke filluar me raportimet për parregullsitë në menaxhimin e lëndëve në institucionet tona të drejtësisë e deri te rastet tashmë të njohura mediale. Reforma në drejtësi parashikon një serë masash për rivlerësimin dhe riverifikimin e punonjësve të sistemit të drejtësisë, proces

ky i njohur si procesi i Vetingut. Në kohën e fundit te ne në Kosovë ka filluar të qarkullojë në opinionin publik ideja e Vetingut. Duke u nisur nga kjo, lind pyetja shumë e logjikshme? A është iniciativë serioze për ta bërë pastrimin e sistemit të drejtësisë nga njerëzit që janë të thirrur për të vënë drejtësi, e vet janë të ndjekur nga drejtësia, apo është temë e krijuar për konsum ditor politik, e jo ide serioze për ta nxjerrë sistemin e drejtësisë nga kjo gjendje në të cilën është. Termi Veting, para së gjithash, për shumëkënd, është edhe i paqartë si i tillë, sidomos për opinionin e gjerë. Fjala veting rrjedh nga gjuha angleze "vetting", që do të thotë kontroll i hollësishëm i figurës së dikujt përpara se t'i ofrohet një pozicion pune, titull, pozitë. Për të pasur sukses ky proces i verifikimit, do të duhej ta përfshinte verifikimin në tri drejtime: verifikimin e pasurisë, të figurës-personalitetit dhe

vlerësimin profesional. Vlerësimi i pasurisë: çdo subjekt duhet t'i nënshtrohet vetëdeklarimit, pastaj kontrollit të të gjitha pasurive të tij dhe personave të lidhur me të (familiarëve drejtpërdrejt). Subjekti duhet t'i justifikojë pasuritë e tij mbi bazën e burimeve të ligjshme. Burime të ligjshme do të konsiderohen vetëm të ardhurat e deklaruar, për të cilat ka paguar taksat. Nëse pasuria e deklaruar apo e zbuluar është më e madhe se dyfishi i të ardhurave të ligjshme, individit paramendohet fajtor dhe përjashtohet nga sistemi, nëse nuk arrin të vërtetojë të kundërtën. Vlerësimi i figurës dhe personalitetit: çdo subjekt do të bëjë fillimisht vetëdeklarim për figurën e tij, pastaj do t'i nënshtrohet verifikimit të kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, e nëse verifikohen kontaktet e tilla, individit paramen-

dohet fajtor dhe shkarkohet menjëherë, nëse nuk arrin ta vërtetojë të kundërtën. Vlerësimi i aftësive profesionale: çdo subjekt do t'i nënshtrohet vlerësimit të aftësive për të gjykuar (për të hetuar e ngritur akuzë në rastin e prokurorëve), aftësive organizative. Subjekti që do të vlerësohet se ka mangësi, të cilat nuk mund të korrigjohen përmes edukimit, do të shkarkohet menjëherë. Praktikë e mirë për Ligjin mund të merret implementimi i tij në Shqipëri ku, sipas organizatave të huaja që e monitorojnë sistemin e drejtësisë atje, e vlerësojnë si nismën më të qëlluar ligjore që ka marrë ndonjëherë ky shtet, si pjesë e reformës në sistemin e drejtësisë. Duke mbetur ende në Republikën e Shqipërisë, atje kanë paraparë që këtë proces ta monitorojnë organizmat e specializuar ndërkombëtar. Në Ligjin për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe

Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë thuhet se qëllimi i këtij është të përcaktojë rregulla të qarta për ta garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimit të besimit të qytetarëve ndaj këtyre institucioneve. Kjo formë do të ishte e përshtatshme të përdorej edhe te ne, sidomos monitorimi nga ndërkombëtarët të këtij procesi mjaft të ndjeshëm e jetik, për një sistem të drejtësisë ligjor. Duke e parë nevojën e madhe për reforma rrënjësore në sistemin e drejtësisë në Kosovë, veprime konkrete në pastrimin e figurave që janë pjesë e sistemit të drejtësisë, shpresojmë se kjo iniciativë të jetë serioze e duke ia besuar profesionalistëve me bashkëpunëtorë ndërkombëtarë në përmblylljen e këtij procesi dhe që kjo iniciativë të mos mbetet vetëm një temë e krijuar për konsum ditor politik.

Lahuta është instrumenti më i lashtë dhe kryesori në Eposin e Kreshnikëve

PRISHTINË, 7 DHJETOR (ER) - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në përputhje me mandatin e vet ligjor dhe aktet e tjera që rregullojnë fushën e trashëgimisë kulturore, në vazhdimësi është e përkushtuar për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Kështu është bërë me dije në një komunikatë për media të kësaj ministrie. "Krahas kësaj dhe në përputhje me objektivat strategjike, një rëndësi të veçantë i kushton edhe promovimit të trashëgimisë kulturore. Në vazhdimësi e përpjekjeve për ta kompletuar inventarin, studimet, hulumtimet dhe interpretimet në fushën e trashëgimisë kulturore, me theks të veçantë të asaj jomateriale dhe promovimit gjithësesi, ka mbështetur punën e Komisionit Ndërqeveritar për Eposin e Kreshnikëve, me theks të veçantë punimin e filmit dokumentar për Eposin e Kreshnikëve", është bërë me dije në komunikatën e MKRS-së. Sipas kësaj ministrie, dosja për Eposin e Kreshnikëve është punuar në përputhje me kriteret ndërkombëtare dhe bazuar në dispozitat e Konventës për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, kurse është hartuar nga grupi i specialistëve më eminentë të Kosovës



dhe Shqipërisë, prof. dr. Zymer Neziri, prof. dr. Shaban Sinani dhe akademik Vaso Tole. "Filmi dokumentar është punuar nga regjisori Orhan Kërkezi në bashkëpunim me specialistët e sipërpërmendur. Në kuadrin e filmit dokumentar të eposit dhe të folklorit burimor në fokus është instrumenti muzikor lahuta, që përfaqëson akretipin më të lashtë të veglave kordofone



me hark të kontinentit evropian dhe që shoqëron këngët e kënduara", është thënë në komunikatë. Sipas MKRS-së, qëllimi i përfshirjes së Eposit të Kreshnikëve në Listën e Përfaqësimit të Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore të UNESCO-s ka qenë dhe do të mbetet si i tillë, pra përfshirje e monumentit më të lashtë të etnokulturës si një nga

shtyllat kryesore të trashëgimisë jomateriale dhe një nga pikat më të ndritshme evropiane dhe botërore. "I kategorizuar si i tillë ka dhe do të ketë për qëllim respektin e vazhdueshëm ndërmjet komuniteteve, grupeve e individëve si dhe do ta promovonte respektin për diversitetin kulturor. Për shkak të rrethanave të asaj periudhe, parashtrimi për Eposin e

Kreshnikëve në UNESCO nuk ka ndodhur sikundër që është aspiruar fillimisht anëtarësimi i Kosovës për t'i ndjekur tutje procedurat e rregullta", është thënë në komunikatën e MKRS-së. Në këtë relacion, MKRS-ja ka dhënë dhe statusin ligjor për Eposin e Kreshnikëve në kuadër të Listës së Trashëgimisë Kulturore nën kategorinë e V-të Trashëgimia Shpirtërore.



PIANISTJA SHQIPTARE QË

Pianistja Ermira Zyrakja-Lefort po nderon dhe afirmon kulturën shqiptare në Zvicër. Në fakt, ajo është një ambasadore e denjë e prezantimit të kulturës së mirëfilltë shqiptare. E pasionuar deri në fund në profesionin e saj, ka bërë që sallat koncertale zvicerane të luajnë me piano e të këndojnë shqip



Shkruan Ismet RASHITI

Emër i njohur në botën shqiptare. Qysh në moshën gjashtëvjeçare ka filluar të specializohet për piano në Tiranë për të ecur gjithnjë sigurt në rrugën e karrierës tash e pesë dekada me radhë. Këto ditë, ky emër, sidomos talenti dhe kontributi i saj, ka sprovuar penën time prej publicisti, e cila, sado me një përvojë të gjatë, nuk e ka aspak të lehtë të shkruajë për një personalitet të këtij kalibri kulturor. Është kjo pianistja shqiptare, Ermira Zyrakja-Lefort, e cila prej vitesh jeton dhe punon në Gjenevë. Jo një herë gjatë historisë shteti zviceran ka qenë mirëpritës dhe u ka dhënë mundësi shqiptarëve ta shpalosin talentin e tyre dhe të kontribuojnë për ruajtjen e vlerave kulturore tradicionale shqiptare, duke i ngulitur rrënjët e saj të vjetra në universin kulturor evropian dhe botëror.

Nuk ka dyshim se gjurmëve të kësaj trashëgimie të pasur kulturore shqiptare po ec sigurt pianistja

e njohur, Ermira Zyrakja-Lefort, gjithnjë modeste dhe e heshtur para opinionit. Në fakt, në të shumtën e rasteve është e zakonshme që njerëzit e karrierës profesionale të duken sa më të thjeshtë dhe të tërhequr, sidomos pianistët duket sikur çdo moment të jetës duan ta kalojnë mbi tastierën e pianos bashkë me tingujt e ëmbël të saj.

E veçanta tjetër është se ky kalibër intelektualësh nuk dëshiron të flasë asnjëherë në vetën e parë, as të rrahë gjoks para të tjerëve, meqë vetvetiu flasin puna dhe sukseset e tyre. E tillë është edhe Ermira Zyrakja-Lefort, e cila më tepër preokupohet për (mos)arritjet e kulturës shqiptare sesa për punën e madhe dhe sukseset e njëpasnjëshme të saj në botën e pafund të artit.

Vetëm pas insistimit tim dhe jam i prirur të mendoj, më tepër, për shkak të respektit ndaj publikut, kam arritur pak a shumë të shkëpus të dhëna interesante nga jeta dhe veprimtaria e saj në Zvicër.

Është diplomuar me sukses në konservatorin superior të Tiranës për piano soliste, pedagoge dhe pianiste shoqëruese. Njerëzit mund të lindin talentë të një fushe, por të dalluar dhe të mëdhenj i bënë puna, insistimi dhe dëshira për ta arritur kulmin profesional. Ermira Lefort është e tillë: Talente e



Pianistja Ermira Zyrakja-Lefort në njërin nga koncertet e shumta në Zvicër

lindur, punëtore e madhe, insistuese, ambicioze, por edhe e guximshme për ta arritur "zenitin". "Qysh në moshën e fëmijërisë kam dashur me zemër e me shpirt të bëhem pianiste. Mendoja kur të rritem të luaj vetëm në skenë, pa pasur nevojë të më shoqërojnë grupe muzikantësh". Kjo dëshirë jo

për shkak të egos personale, por thjesht për shkak të intuitës muzikore dhe shpirtit elegant që kishte filluar të shpërfaqej në karakterin e saj.

Në moshën 14-vjeçare ka filluar të ngjitet në shkallët e karrierës me çmimin e fituar në Konkursin Mbarëkombëtar për të Rinj në Radio Televizionin Shqiptar. Sigurisht ky ka qenë një moment i veçantë për një vajzë të re, plot elanë dhe ëndrra për trasimin e mëturjeshëm të rrugës jetësore.

Vendosja e papritur në Gjenevë, pavarësisht se kishte për cak Rotterdamin holandez, meqë aty kishte fituar një bursë dyvjeçare për master, më tepër duhet kuptuar si një dhuratë prej Zotit për mërgatën shqiptare në Zvicër. Tri koncertet e para në Cite Blëu të Gjenevës dhe bisedat e gjata për muzikën dhe Shqipërinë për të cilën atë botë dihej shumë pak me Fransua Lefort, ishin momentet që Ermira të vendoset në Gjenevë, në këtë qytet shumëngjyrësh që të jep mundësi të mëdha për jetë dhe perspektivë. Piano ishte instrumenti dhe çelësi magjik që ia hapi rrugët e jetës. Pa vonuar shumë, Ermira Lefort, si një gur i Nitonit në liqenin e lashtë Lëman, filloi t'u bëjë ballë dallgëve të jetës që përplaseshin furishëm në jetën dhe

karrierën e saj në të ardhmen. Nuk ishte e lehtë përballja me konkurrencën intelektuale e kulturore në pellgun e Gjenevës së madhe. Duhej punë, talent, përkushtim dhe guxim për t'u futur në malin e dendur të kulturës botërore që prej shekujsh kishin zënë vend në zemër të këtij qyteti. Në fakt, Ermira i kishte të gjitha këto mundësi intelektuale, virtyte dhe vlera njerëzore.

Falë punës së madhe filluan t'i hapen dyert e sallave më prestigjioze koncertale. Kudo duartrokite, mirënjohje dhe falënderime. Sallat e këtij qyteti muzikal sa të mëdha, po aq intime, sot e dy dekada me radhë mbushen përplot me publik dhe emocione teksa luan me piano, Ermira Lefort, veprat e kompozitorëve më të njohur botërorë si ato të gjermanit Ludwig van Beethoven, italianit Antonio Lucio Vivaldi, austriaku më i vjetër i klasikëve të Vienës, Franc Jozef Hajden dhe sidomos kompozitori i njohur, përfaqësuesi i epokës moderne, Wolfgang Amadeus Mozart e të tjera. Teksa dëgjon tingujt e pianos së Ermirës, s'ke si të mos ndihesh krenar me originën tënde. Një femër shqiptare elegante, në dukje e heshtur dhe me një buzëqeshje dashamirësie për publikun, s'ka si



Ermira Lefort këto ditë, në "Ditët e Mbretëreshës Teuta 2018", në Dubrovnik të Kroacisë

PO SHKËLQEN NË ZVICËR



të mos e magjepsë edhe spektatorin më të tërhequr ndaj muzikës klasike. Lëvizjet energjike e me shumë mjeshtri të gishtërinjve, të fusin në pellgun e dëshirave, të japin shpresë për jetë e ta mbushin zemrën me optimizëm për një të ardhme më të mirë të të gjithë njerëzve, pavarësisht vendit nga kanë ardhur, origjinës apo ngjyrës së tyre.

Ermira Lefort është pianiste me diplomë shtetërore franceze dhe zvicerane. Si e tillë ka arritur të shfaqë shumë koncerte me muzikë klasike solo, por edhe me artistë të tjerë në shumë shtete si në Francë, Angli, Greqi, Irlandë, Slloveni, Kroaci, ShBA e gjetiu. Një punë të madhe bënë me federatën e tre konservatorëve në Gjenevë dhe përgatitjen e opsionit Piano për kolegjet në kolegje. Ermira Lefort, po ashtu, ka marrë pjesë në Kongresin Evropian të Pianistëve të mbajtur në Qipro, në koncertin studimor mbi veprat e kompozitorëve shqiptarë për piano. Është e para që ka nxjerrë CD-në me titull "E jona muzikë" me vepra për piano të kompozitorëve shqiptarë, e cila është vlerësuar lart sidomos në Boston dhe nga kritika franceze. Përmes kësaj CD-je ka pasur qëllim të prezantojë kompozitorë shqiptarë shumë të talentuar dhe krijimet e tyre të mrekullueshme të cilat, për arsye të sistemit, nuk kanë

pasur mundësi të njihen nga spektatori dhe kritika e huaj.

Krahas punës pedagogjike me nxënës për piano, Ermira që në ditët e para të vendosjes në Gjenevë ka qenë pjesë e pandarë e të gjitha tubimeve kulturore dhe me karakter kombëtar të komunitetit shqiptar në Zvicër. Ndonëse e angazhuar tej mase me prezantimin e artit klasik, ka marrë kontakt me shoqatat ekzistuese shqiptare. U angazhua konkretisht dhe ka luajtur rol të madh në të gjitha zhvillimet kulturore: "Në ato vite kishte shumë më pak shqiptarë me familje. Më duhej ta thyhej tabunë për të hyrë në një sallë, apo shoqatë dhe për të folur rreth rëndësisë së pianos dhe për korale këngësh për fëmijët të cilët në ato vite ishin më të paktë në numër", kujton Ermira. Ishte kënga dhe pianoja e Ermirës e cila për shtatë vjet rresht realizoi projektin me "Rinia kontakt", i cili kishte për objektin integrimin me anë të muzikës përmes pianos dhe këngës. Kjo kishte ndikuar së tepërmi që fëmijët shqiptarë ta ndejnë më shumë botën fëmijërore, sidomos gjatë periudhës kur në çdo familje përjetohejshin rënd ngjarjet e luftës në Kosovë dhe pasojat e saj të rënda. Ky projekt kishte ndikuar që nga një veprimtari muzikore të kalohet në një pasion për fëmijët adoleshentë. Nga përgatitjet që bënte Ermira Lefort, çdo vit 3 deri 6 nxënës kalonin me sukses audicionin dhe regjistroheshin në konservatorë të Gjenevës. "Edhe sot emocionohem së tepërmi kur i shoh të rritur e studentë të mirë të gjithë ata vogëlush të dikurshëm", thotë Ermira.

Pavarësisht prej angazhimeve të shumta profesionale, Ermira Lefort ka mbështetur pa hezitim koncerte, mbremje letrare dhe muzikore, ekspozita pamore, aktivitete përkujtimore për heronjtë dhe figurat e tjera historike si: Akademi për Skënderbeun e Nënë Terezën, organizuar nga misionet katolike si dhe promovime librash të autorëve me emër. "Me emocion të veçantë flet për projekt-koncertin e ideuar nga prof. dr. Michele Greco me grupin 'Vëllezërit arbëreshë' me repertuar të këngëve arbëreshe dhe jo vetëm plus trio e artistëve shqiptarë me këngë dhe vepra lirike shqiptare që u mbështet me zemër nga Shoqata 'Iliria' dhe presidentja e saj, Luljete Hoxha-Deda".

Për punën e madhe profesionale dhe angazhimin e saj në fushën e artit dhe të kulturës, Ermira është vlerësuar disa herë me çmime prestigjioze si artiste në diasporë dhe për diasporën por, falë modestisë së saj, me mirësjellje shumë prej tyre nuk ka pranuar t'i marrë, me arsyetimin se të gjitha i ka bërë me vullnetin më të madh për afirmimin e kulturës dhe të popullit shqiptar. "Vlerësimi më i mirë për mua, thotë Ermira, është publiku i mrekullueshëm që më mbanë gjal-

lë dhe të lumtur në jetë. Ndihej mirë kur ndodhem para pianos dhe kur shoh publikun që më duartroket".

Megjithëse e angazhuar së tepërmi me koncerte për nder të festave kombëtare të nëntorit, Ermira po përgatitet për dy recitale me soprano dhe një tjetër me violinë. E

gjithë kjo veprimtari do të bëhet menjëherë pas kthimit të saj nga Kroacia, ku po qëndron me ftesë të Shendia Bilallit në "Ditët e Mbretëreshës Teuta 2018" që u mbajt në Dubrovnik.


Për ta përsosur sa më shumë artin e saj, Ermira kalon disa orë pranë pianos: "Është me të vërtetë vendi

vetëm ku ndihem sikur mund të kem një retrospektivë rreth vetes dhe të kuptoj emocionet që unë jetoj në jetën e përditshme". Përkundër këtij mendimi, pianistja Ermira Lefort, për të mbajtur ekuilibrin sa më të mirë të jetës, bën aktivitete të tjera si, ecje në male ose pranë liqenit të bukur Lëman. Po ashtu, i ka shumë përzemërt udhëtimet, poezinë, prozën e shkurtër, fotografinë dhe vallëzimin. "Unë nuk mund të jem një robote mbi piano, sepse kjo nuk do të më ndihmonte. Realisht nuk do të kisha mundësi të shprehi asnjë ndjenjë në piano nëse nuk bëj jetë normale njerëzore", ka thënë ajo.

Gjatë dy dekadave të fundit ka qenë e pranishme anembanë Zvicrës me koncertet e saj me piano. Ka qenë aty ku e ka ftuar zëri shqiptar në shërbim të ruajtjes dhe afirmimit të vlerave të mirëfillta kulturore. Sikurse dje, edhe sot e gjithë ditën, pothuaj nuk ka aktivitet me karakter kombëtar dhe kulturor që të mos ftohet Ermira. "E ndiejë për obligim moral ndaj popullit tim dhe kulturës sonë të lashtë të jem aty ku mund t'i kontribuoj".

Në fakt, angazhimi profesional i Ermirës ka luajtur rol të veçantë në paraqitjen e vlerave kulturore, arsimore, integruese dhe emancipuese në mërgatën shqiptare.

Me të drejtë mund të thuhet se Ermira Lefort është një nxënëse e mirë dhe besnike e kompozitorëve më të njohur evropianë, veprat e të cilëve i luan me përkushtim, pasion dhe profesionalizëm të madh. Mbresa të veçanta gjatë interpretimit në koncertet solo lënë sidomos modestia, kultura njerëzore, buzëqeshja e qetë dhe lëvizjet e matura në skenë, duke treguar kulturë dhe respekt maksimal për publikun në sallë.



Ermira Zyrakja-Lefort, autore e CD-së "E jona muzika", me vepra për piano të kompozitorëve shqiptarë, e vlerësuar lart në Boston dhe nga kritika franceze.



Pianistja Ermira Lefort gjithnjë pranë pianos: "Krenare që jam shqiptare dhe po punoj për afirmimin e vlerave kulturore të popullit tim të lashtë"

E rrallë

I burgosuri zgjedh karrigen elektrike në vend të injeksionit vdekjeprurës



Një i burgosur në Tennessee ka zgjedhur të vdesë në karrigen elektrike në vend të injeksionit vdekjeprurës. David Earl Miller, i dënuar me vdekje, u ekzekutua në karrigen elektrike pas debateve se injektimi do t'i

shkaktonte më shumë vuajtje. Ai ishte i fundit mes një numri në rritje të burgosurish që u përpoqën ta shmangnin injektimin vdekjeprurës pas disa ekzekutimeve të dështuara.

FOTO E DITES



Një grua ecën në borë në një pyll në bregun e lumit Yenisei, me temperaturën e ajrit rreth minus 32 gradë celsius, pranë qytetit siberian të Krasnoyarskit në Rusi. /Reuters/

BARSOLETA E DITËS



Mësuesja jep temën e esesë: "Nëse do të ishe drejtor i një ndërmarrjeje...". Të gjithë nisin të shkruajnë, përveç Benit. Pas pak, mësuesja e pyeti:
- Po ti, pse nuk shkruan?
- Kjo nuk është puna ime, por e sekretarëshës, mësuese!




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

"ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

"JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

"NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

"SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

"VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

E jashtëzakonshme

Mban në shtëpi pesë krokodilë

Krokodilët janë një prej specieve më të rrezikshme në planet. Ta mbash një të tillë si kafshë shtëpiake vë në rrezik jetën tënde dhe jo vetëm. Por një 60-vjeçare nga Australia ka treguar se mund të bashkëjetojë jo me një, por me pesë krokodilë. Ajo thotë se nuk ka aspak frikë nga krokodilët e vet.



 <p>DASHI Këtë ditë do të keni logjikë të ftohtë për marrjen e vendimeve, por do të jeni edhe mjaft të ndjeshëm karshi personave që ju duan.</p>	 <p>DEMI Ditë e çuditshme që më shumë do të merreni me plane udhëtimesh se me punën tuaj rutinë. Nuk jeni mësuar me këto ritme dhe dita sot do t'ju lodhë.</p>	 <p>BINJAKËT Sot do të jeni shumë korrekt me takimet, gjë që nuk ndodh zakonisht me ju. Në mbrëmje do t'ju pëlqejë surpriza që ka përgatitur partneri.</p>	 <p>GAFORRJA Po mundoheni të vendosni rregull në një vend që ka pllakosur kaosi. Nuk do t'ia dilni dot mbanë të vetëm, kështu që kërkonin ndihmë.</p>	 <p>LUANI Duket sikur nuk po ju dëgjojnë dhe nuk po ju kuptojnë. Mbase është perceptimi juaj i gabuar sepse do të keni rezultate shumë të shpejta.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Mendime të kundërta ju turbullojnë mendjen dhe nuk dini se nga të pozicionoheni. Është mirë ta dëgjoni zemrën ndonjëherë.</p>
 <p>PESHORJA Si në jetën në çift ashtu edhe në familje, këtë periudhë do të dilni si persona që nuk kënaqen kurrë. Ju thjesht doni të jeni e përkryer.</p>	 <p>AKREPI Intuita sot nuk do t'ju lerë në baltë. Në shumë raste do të kishit gabuar, por sot do të jeni mjaft përpara vetëm falë indicies që keni.</p>	 <p>SHIGJETARI Pak interes për të komunikuar me njerëzit sot dhe dëshirë mjaft e madhe për të qenë më afër me natyrën dhe për aktivitete sportive.</p>	 <p>BRICJAPI Sot do ta nisni ditën me këmbën e mbarë dhe po kështu do ta përfundoni. Duhet t'i falënderoni yjet që janë në anën tuaj këtë ditë.</p>	 <p>UJORI Megjithëse këtë periudhë jeni të mbingarkuar, do të gjeni pak kohë për të kaluar në shoqëri të mirë. Miqtë janë ata të të cilët mbështeteni gjithmonë.</p>	 <p>PESHQIT Dashuria është ajo që ju ndjek gjatë gjithë ditës së sotme. Por, jeni ju që po tregoheni pak indiferent në këto çaste dhe nuk i kushtoni rëndësi.</p>

Dua Lipa, mahnitëse në koncertin e "Jingle Ball"



Këngëtarja shqiptaro-britanike Dua Lipa po vazhdon të shijojë suksese të shumta në skenën ndërkombëtare dhe në koncertin "Jingle Ball" të mbajtur në Filadelfia ajo ka shkëlqyer. Lipa ka performuar

për mijëra fansa hitet e saj më të fundit, duke 'ndezur' skenën. Por, ajo ka rrëmbyer vëmendjen edhe me veshjen, pasi me bluzën e zezë dhe fustanin e shkurtër ngjyrë mente dukej shumë atraktive.

Priyanka Chopra në listën e 100 grave më të fuqishme në botë



Aktorja Priyanka Chopra së fundi u martua me bashkëshortin e saj Nick Jonas. Ajo hyri në listën e "Forbes" për gratë më të fuqishme në botë.

Në këtë listë ajo u rendit e 94-ta. Aktorja me anë të një postimi në "Instagram" e ka falënderuar revistën "Forbes" për këtë përzgjedhje.



Halle Berry tërheq vëmendjen

Ajo është një nga gratë më të njohura në Hollywood. Halle Berry ka marrë gjithë vëmendjen kur është paraqitur në tapetin e kuq në gala ngjarjen e

lansimit të Pirelli Calendar 2019, në Milan të Italisë. Aktorja 52-vjeçare, fituese e çmimit Oscar, ka shkëlqyer me një fustan ngjyrë rozë të hapur, me një çarje të thellë te këmbët.

Angelina e Bradi, bashkë për t'i festuar Krishtlindjet



Çifti i çuditshëm, Brad Pitt dhe Angelina Jolie, sipas disa raportimeve të fundit, janë afër një marrëveshje në lidhje me fëmijët e tyre për kohën e krishtlindjeve. Që nga viti i kaluar,

Brad dhe Angelina janë në një betejë kujdestarie për gjashtë fëmijët e tyre. Por, megjithëkëtë, çifti ka vendosur për një marrëveshje miqësie për ta kaluar kohën e festës së bashku për fëmijët.

Heather Nauert, ambasadore e ShBA-së në OKB

UASHINGTON, 7 DHJETOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, e zgjodhi zëdhënësen e Departamentit të Shtetit, Heather Nauert, në postin e ambasadores së ShBA-së në Kombet e Bashkuara. Trumpi e bëri njoftimin për

gazetarët në Shtëpinë e Bardhë. Nauert, ish-moderatore dhe korrespondente e televizioneve ABC dhe Fox News, do të pasojë Nikki Haleyn, e cila ka njoftuar në tetor se do ta lërë postin në OKB në fund të vitit. "Ajo është e shkëlqyeshme. Ajo ka qenë me ne për kohë të

gjatë", u ka thënë Trump gazetarëve më 1 nëntor, kur ka njoftuar se po shqyrton emërimin e Nauertit. Emërimi i Nauert, 48 vjeçe, është një zgjedhje e pazakonshme për postin diplomatik, pasi ajo nuk ka përvojë paraprake në politikëbërje.



Annegret Kramp-Karrenbauer, pasardhësja e Angela Merkelit në CDU

Kongresi i CDU-së të premten ka zgjedhur Annegret Kramp-Karrenbauer për kryetare të re të CDU-së, ku mori 51 për qind të votave. Ka qenë kryeministre e suksesshme në landin e vogël Sarland, ku drejtoi një koalicion tripartiak. Merkel vazhdon të mbetet kancelare e Gjermanisë deri në përfundim të mandatit në vitin 2021



me një duartrokitje të gjatë prej gati 10 minutash. 1001 delegatët e mbledhur në Hamburg u ngritën në këmbë, shumë prej tyre mbanin pankarta me mbishkrimin: "Faleminderit shefe". Nuk mungonin as lotët te shumë delegatë. Ndërsa Merkel gjatë fjalimit ishte shumë personale dhe e prekur nga duartrokitjet e gjata, të cilat e ndërprejnë shpesh fjalimin e saj. 64-vjeçja Angela Merkel largohet nga posti i kryetares së partisë CDU pas plot 18 vitesh. Por ajo vazhdon të mbetet kancelare e Gjermanisë.

PRISHTINË/BERLIN, 7 DHJETOR - Annegret Kramp-Karrenbauer nga e premija është kryetare e re CDU-së. Ajo mori 51 për qind të votave në Kongresin e CDU-së të mbajtur në Hamburg. Para votimit ajo u tha delegatëve se ka personalitetin e vet dhe nuk është një "mini Merkel".

Në fjalën e saj pas zgjedhjes, Annegret Kramp-Karrenbauer pranoi e emocionuar fitoren me diferencë të vogël votash. Në raundin e dytë të zgjedhjeve, ajo mori 517 vota, kurse konkurenti i saj Friedrich Merz mori 482 vota. Jens Spahn u eliminua në raundin e parë të votimit.

Annegret Kramp-Karrenbauer ishte shprehur më parë se në rast fitoreje si kryetare ajo do të

mbështeste qëndrimin në post të kancelares Merkel deri në fund të mandatit të saj në vitin 2021.

Duke iu drejtuar delegatëve në krye të votimit, Kramp-Karrenbauer foli për perceptimin që ajo është një "mini-Merkel". "Njerëzit më konsiderojnë një kopje, më shumë nga e njëjta gjë, por unë mund t'ju them se qëndroj këtu me personin tim, si vetja ime", tha ajo.

56-vjeçja Kramp-Karrenbauer ishte kandidatja e preferuar e kancelares Angela Merkel. Më parë ajo ka qenë kryeministre e suksesshme në landin e vogël Sarland, ku drejtoi një koalicion tripartiak. Ajo ka reputacionin se është e aftë të bashkojë pozicione të

ndryshme brenda CDU-së dhe një talent për aleanca me parti të tjera.

Friedrich Merz dhe Jens Spahn, dy konkurrentët e uruan fituesen dhe i premtuan bashkëpunim në forumet e partisë.

Kryetarja e deritanishme e partisë kristiandemokrate CDU Angela Merkel, u largua nga ky post, pas 18 vitesh, me një fjalim, i cili u përcoll me brohoritje dhe duartrokitje frenetike. "Ka qenë një nder i madh, një kënaqësi e madhe". Me këto fjalë Merkel

përfundoi fjalimin 35 minutësh, për herë të fundit si kryetare e CDU-së. Merkel bëri një rishikim të kohës në krye të partisë, duke theksuar sukseset por edhe dështimet në faza të ndryshme. Kancelarja tha se tani ka ardhur koha "për një kapitull të ri", dhe ftoi partinë e saj që të mbetet e bashkuar.

Ndarja me lot dhe duartrokitje

Pas fjalimit ajo u përshëndet

Ambasada amerikane në Jerusalemin, përsëri në qendër të debateve

TEL-AVIV, 7 DHJETOR - Kur presidenti amerikan Donald Trump njoftoi njohjen e Jerusalemit si kryeqytetin e Izraelit dhe e zhvendosi Ambasadën amerikane nga Tel-Avivi në Jerusalemin në maj të këtij viti, izraelitët e bekuan, ndërsa palestinezët e mallkuan. Tani, një vendim amerikan për të bashkuar konsullatën e vjetër me Ambasadën e re në Jerusalemin në Qytetin e Shenjtë, ka shkaktuar edhe më shumë zemërim tek

palestinezët.

Për palestinezët, kjo lëvizje do të thotë një ulje të nivelit të marrëdhënieve, një fyerje e mëtejshme pas lëvizjes së Ambasadës amerikane në Jerusalemin, që në vetvete disa e interpretojnë si shenjë se Uashingtoni kishte vrarë çdo shpresë për një shtet të pavarur palestinez me Qytetin e Shenjtë si kryeqytet.

Për izraelitët, kjo legjitimon pretendimin se Jerusalemi është



kryeqyteti i tyre i pandarë, një premtim që Uashingtoni e kishte bërë para shumë kohësh, dhe që presidenti Trump më në fund e përmbushi.

Ambasada e re në shtetin hebraik po merr konsullatën e Jerusalemit, që gjithmonë kishte shërbyer si lidhje direkte e palestinezëve me Uashingtonin. Tani atyre u duhet ta bëjnë këtë përmes ambasadorit amerikan, David Friedman, një ide që indinjton shumë vetë që e akuzojnë atë se është i njëanshëm në favor të Izraelit.

Në pjesën arabe në lindje të Jerusalemit, mes zemërimit,

zhgënjimit dhe dëshpërimit, mesazhi është i qartë.

"Është një lajm shumë i keq për palestinezët. Mandati i Konsullatës së Përgjithshme për territoret palestineze të Bregut Perëndimor nuk ekziston më, çka do të thotë që zgjidhja me dy shtete dhe dy kryeqytete nuk ekziston më", thotë Rami Nasrallah, nga Qendra Ndërkombëtare për Paqe dhe Bashkëpunim.

Papa Françesku, vizitë në botën islame

VATIKAN, 7 DHJETOR - Papa Françesku, që afrimin e Krishtërimit me Islamin e ka kthyer në një gur themeli të Papatit të tij, do të vizitojë në muajin shkurt Abu Dhabin, në Emiratet e Bashkuara Arabe. Kjo është vizita e 7 e Atit të

Shenjtë në një komb me shumicë myslimane, në të cilën pritet të bëjë thirrje për paqe brenda besimeve.

Udhëtimi historik do të mbahet nga data 3 deri më 5 shkurt. Papa argjentinas ka vizituar deri më tani Turqinë, Jordaninë,

Egjiptin, Bangladeshin, Azerbajxhanin dhe territoret palestineze, e të gjitha këto ndalesa i ka shfrytëzuar për të ngritur ura dialogu mes feve, teksa e ka dënuar dhunën në emër të Zotit.

Ftesën në Abu Dhabi, kreut të

Kishës Katolike ia bëri princi i atjeshëm i kurorës, sheiku Mohammed bin Zayed al-Nahyan, si dhe Kisha lokale Katolike. Princi shkroi në "Twitter" se, Papa është simbol i paqes, tolerancës dhe promovimit të vëllazërisë.



Historia e John Lennon, si e “hipnotizoi” e dashura japoneze



I verbuar dhe fjalë për fjalë “hipnotizuar” nga Yoko Ono. Pra, Ray Connolly përshkruan John Lennon (të cilin ai e takoi në vitet 1960 dhe me të cilin u bë mik) në librin e ri të dedikuar për të: “Të jesh John Lennon: Një jetë pa trazirë”.

Sipas Connolly, një grua e vogël japoneze e veshur me uniformë të zeze intelektuale e ka ndjekur atë pothuajse gjithmonë, me anë të letrave dhe kudo që shkonte. Ai e kishte prezantuar si heroinë dhe kur marrëdhënia e tyre ishte në krizë, dashuria e tyre mbi-zotëroji.

Rrëfimet e Connolly, në biografinë e re përkojnë me 38-vjetorin e vdekjes së muzikantit nga Liverpool dhe zbardh detaje të marrëdhënies së tij në çift me Yoko Onon.

Yoko “hyri në orbitën e Beatles” pas takimit me John Lennon në Galerinë Indica në Londër. Ishte dhjetor 1966. Sipas Connolly, megjithatë, takimi nuk ishte aksidental, siç thotë artistja japoneze, por “e organizuar” nga Yoko Ono, e cila ishte aty për të paraqitur një ekspozitë dhe ishte në kërkim për financim dhe

sponsorë.

“The Beatles” me famën që kishin arritur deri atëherë, mund t’i ofronin ato.

Gjithçka llogaritet, sipas autorit të librit. “Që nga fillimi i karrierës së saj, Yoko Ono kishte kuptuar fuqinë e rrjetëzimit dhe në veçanti vetë-promovimin”, shkruan Connolly.

John “ndjeu se ajo ishte ylli dhe ai audienca”, pasi kurrë nuk e kishte takuar askënd si kjo “grua e çuditshme japoneze e veshur me uniformën e zeze intelektuale”.

Ajo vazhdoi duke e kërkuar atë, për të shkruar letra të panumërtat, për të ndjekur atë kudo ishte dhe teksa lexonte për mbledhjen e tij të poezive Lennon dhe ajo u verbuar dhe ranë si të çmendur në dashuri, duke bërë që ai të linte gruan e tij dhe ajo të dashurin e saj.

Yoko menjëherë përdori supermacinë dhe u përpoq të ishte atje gjatë të gjitha datave historike të Beatles.

Apple Records nuk e donin vërtet atë dhe e kujtojnë Yokon si “një person shumë të bezdisshëm...”.



Mimi, teza e John Lennon, e kishte quajtur atë “xhuxhja e helmuar”. Megjithatë, ndërhyrja e Yokos kishte efekte negative në grup dhe veçanërisht në marrëdhëniet midis John dhe Paul, mosmarrëveshjet dhe keqkuptimet e të cilëve e çuan Lennonin në një moment krize, madje edhe me Yokon.

Historia e tyre e dashurisë duke gati për të prishur në 1972 dhe Yoko, kur çifti sërisht u rilind, për shkak se ajo i dha një mësuese Johnit. May Pang, një vajzë e bukur kineze e cila kishte punuar për terapinë e çiftit.

Prej atëherë çifti rilindi. Yoko Ono mori kontrollin e të gjitha financave të Johnit dhe u bë menaxherja e tij.

Ai filloi të jetonte në heshtje, ndaloi së shkruari dhe jetonte në hijen e asaj gruaje që e kishte në duart e saj dhe prej së cilës ndihej i mbrojtur. Vetëm pas një udhëtimi në Afrikën e Jugut, Lennon u kthye i ngarkuar dhe me një vetëvlerësim të rifituar, gati për t’u kthyer te shkrimi. Por më 8 dhjetor 1980, ai u vra ... Fati kishte vendosur për të.

(gazeta-Shqip.com)



Mafia, historia e origjinës dh

Salvatore Lupo (Donzelli) shkruan për ngjarjet e Cosa Nostra nga shekulli i nëntëmbëdhjetë dhe mohon se bandat ishin favorizuar nga amerikanët

Mafia lindi në mes të shekullit të nëntëmbëdhjetë nga një brinjë në njëfarë kuptimi të "revolucionit" sicilian. Kjo, pra, shkurt teza e librit – Mafia. Njëqind e gjashtëdhjetë vjet histori midis Sicilisë dhe Amerikës, – një dijetar i madh i kësaj teme, Salvatore Lupo.

Libri përmbledh një seri veprash të mëparshme dhe do të botohet nga Donzelli. Disa origjina të largëta të fenomenit, – thotë Lupo, – mund të gjenden në Partinë Demokratike të pronarit të tokave Francesco Bentivegna, i cili në 1848 në Palermo udhëhoqi një grusht njerëzish për të mbështetur kryengritjen anti-Bourbon dhe më pas të lidhur me qarqet radikale që – pas vdekjes së tij – do të kishin frymëzuar ndërmarrjen e keqe të Charles Pisacane në Sapri; ndërkohë, ai kishte mobilizuar një "ekip të popullarizuar" për të "hequr" Palermon përsëri, por ai ishte kapur dhe qëlluar nga ushtarët Bourbon. Ithtarët e tij në vitin 1860 u bashkuan me rrymën radikale garibaldiane.

Vëllai i tij, Giuseppe Bentivegna, në vitin 1862 do të kishte qenë së bashku me Garibaldi në Aspromonte. Të njëjtat konsiderata vlejën edhe për Giovanni Corrao, gjithashtu një revolucionar i vitit 1848, i cili përfundoi në burg dhe në mërgim. Mazziniano "shtyu", Corrao ishte me Garibaldi në kohën e "Mijëvjeçarit" dhe e ndoqi atë në betejën përfundimtare në lumin Volturmo. Komplotistët kundër Borbonit ishin gjithashtu dy miq të Corrao, Giuseppe Badia dhe Francesco Bonafede. "Është e mundur që Corrao dhe Bentivegna", shkruan Lupo me kujdes të duhur, "kanë qenë të lidhur, gjatë udhëtimit të tyre,

me elemente të përcaktuar si proto-mafie". Sa për ata, vazhdon Lupo, i cili u kualifikua si shef i mafias në kohët e mëvonshme, që do të thotë, në post-unifikim, "ne gjejmë në biografinë e tyre jo pak pika kontakti me përvojën revolucionare". Në këtë kuptim, Lupo beson "mund të themi se mafia përfaqësonte frutin toksik të një stabilizimi pasrevolucionar".

Si ndodhi kjo, mund të kuptohet nga një pamflet i botuar në 1864 nga senatori i "leftistit" të moderuar Nicolò Turrissi: Shënime mbi gjendjen e sigurisë publike në Sicili. Turrissi tregon se si në 1848 dhe në 1860 në ishull "ishte në krahë të gjithë sektin e vjetër të hajdutëve, të gjithë të rinjtë që jetonin me punën e kujdestarëve rural dhe klasën e madhe të kontrabandistëve të agro-palermitanos".

Pastaj, pas ndërmarrjes së Garibaldit, një qeveri nuk ishte në gjendje të rivendoste rendin, kështu që sektin tjetër i fermës së njëjtë të lidhur me atë sekt të "trishuar". Turrissi, Lupo, nuk e përdor fjalën "mafia", por përdor fjalë të tjera kyçe: "sekti" në fakt, dhe më pas "camorra", "turp", "përlulësi". Në çfarë kuptimi "përlulësi"? Turrissi shpjegon: "Përlulësia përfshin respektin dhe përkushtimin ndaj sektit dhe detyrimin për të mbrojtur nga çdo veprim që mund të dëmtojë drejtpërdrejt ose tërthorazi bashkëpunëtorët".

Dy vjet më vonë vetë Turrissi do ta thërrasë sektin me emrin e tij të ri, Mafia, duke dëshmuar përpara Komisionit Parlamentar për kryengritjen e vitit 1866. Ai do të thotë: këta njerëz të armatosur "bëjnë vetë ose vendosin kujdestarë të pasurisë; mbrojnë pronat dhe janë të mbrojtura; por ata mbeten



Kapo-mafia, Michele Greco (1924- 2008), i ashtuquajtur "babai", për autoritetin e tij në brendësi të organizatës Cosa Nostra. Në këtë foto, bos shfaqet në Messina, në nëntor 1986 gjatë procesit gjyqësor të Apelit për vrasjen e gjykatësit Rocco Chinnici, i vvarë në vitin 1983 në Palermo nga një auto-bombë me dy njerëz të eskortës që e shoqëronte

malandrini; mafia ishte e mbrojtur nga 'zotërinj që ia vlejti' 48. Dhe rrethi mbyllet.

Herën e parë që termi "mafia" (me dy f) shfaqet në një dokument qeveritar është në një raport nga prefekti i Palermos Filippo Gualterio (1865). Zyrtari shpjegoi se mafia ishte një lloj "camorra", një "shoqatë malandrinesca" në marrëdhënie me "fuqinë", në kohën e udhëhequr nga Corrao i lartpërmendur dhe tani e udhëhequr nga Badia e tij shoqërore. Me fjalë të tjera, "ai e bëri atë të përputhet me Partinë Republikane, me synimin e

qartë të delegimitimit të tij", vëren Lupo. Operacioni politik i Gualterio konsistoi në "bashkimin e aspektit politik dhe penalisht në mënyrë të pavërtetë".

Betimi i parë i mafies i regjistruar në një raport të policisë është 29 shkurt 1876. Rituall, shkruan Lupo, na referohet jo vetëm për të ardhmen e mafies, por edhe për të kaluarën e revolucionit, në veçanti për shitjet "carbonara" dhe ato marrëveshje "juristët (nga të cilët burimet thonë rreth 1848), në bazë të të cilave njerëzit premtuan të

ndjekin klasat e sipërme në luftën kundër despotizmit Bourbon, por duke u angazhuar që të mos e vënë në pikëpyetje rendin shoqëror".

Pas kësaj, mafia jo vetëm që solli fillimisht sugjerime ose modele nga Frankmasoneria, por ndau me të njëjtin muratim "disa karaktere themelore". Këtu Lupo pohon – edhe pa "dashur të kriminalizojë traditën masonike", ai e bën të qartë – se "bandat mafioze dhe llogat masonike janë shoqëri të fetarëve bazuar në idenë e mbështetjes së ndërsjellë, duke



e nga e mori emrin në Itali!



Fortuzzi, në vend të kësaj, tha me entuziazëm dhe donte të specifikonte se ideja e qeverisjes së Sicilianëve “me ligje dhe ordinaanca angleze ose belge, të cilat supozojnë një popull të kulturuar dhe moral si atje ose të paktën pjesërisht superior i gadishullit “, nënkupton” një eksperiment të rrezikshëm dhe të tmerrshëm “. Të destinuar të dështojnë.

Më pas, dyshimet e fshehtësisë u zhvendosën në të djathtë me iniciativën e avokatit të përgjithshëm të mbretit Diego Tajani, i cili pati një përleshje me shefin e policisë së Palermos, Giuseppe Albanese, të cilin e akuzoi për nxitësin e një zinxhiri vrasjesh. Në qershor

të vitit 1875 çështja mbërrin në Parlament, ku deputeti i së majtës Francesco Cordova vuri në dukje indeksin kundër tavolinave qeveritare: “Zotërinj të Qeverisë”, bërtiti ai, “qendra e mafias është në radhët e forcës suaj publike”.

Dhe kur Leopoldo Franchetti me Sidney Sonnin shkoi te Tajani para se të “zbriste” – midis marsit dhe majit 1876 – për të studiuar “rastin sicilian”, njeriu i mbretit u zbuloi atyre se degjenerimi i qeverisë së së Djathtës në Sicili ai kishte filluar, sipas mendimit të tij, në 1866-67 si prefekt Antonio Starabba, marquis Rudinì. Rudinì, tha Tajani, “filloi të punësojë vrasës kundër vrasësve, kështu që për një vrasës ai

shkatërroi ai krijoi katër”.

Dhe përdorimi i forcës për të luftuar mafien? Në vitet e hershme të historisë së Italisë, kur vendi u qeveris nga e drejta historike (1861-76), “sistemi i garancive liberale ende nuk ishte i vendosur mirë dhe rruga e torturuar drejt demokracisë politike sapo kishte filluar”. Beteja e parë e asaj epoke kundër mafies u zhvillua nën shenjë të një sistemi centralistik dhe autoritar të qeverisjes, që nuk përbuzte të mbështeste gjendjen e rrethimit dhe të mbështetej në ushtri.

Ndodhi që “për të mbrojtur idenë e papërpunuar të ligjshmërisë së vet, kënaqet në të gjitha llojet e ilegalizmit substancial”. Në disa periudha historike,

të paktën dy, “Lufta kundër mafies – mbështet Lupon – i kufizuar me mohimin e vlerave, të cilat për ne janë të domosdoshme, respekti për të drejtat individuale dhe kolektive, pa lirinë”. Mafia, është e vërtetë, përfaqëson një patologji të marrëdhënies shoqërore dhe sistemeve përfaqësuese. Por, thotë Lupo, disa nga zgjidhjet që janë propozuar historikisht mund të konsiderohen më keq se sa e keqja në sytë tanë. Dy sezonet duhet të theksohen edhe në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë të së Majtës historike dhe të epokës së hershme republikane, të cilën Lupo e quan “armëpushim të gjatë”.

(gazeta-Shqip.com)



përdorur ritualet barokore për pranimin e neofitëve , ata synojnë ruajtjen e sekretit ». Dhe në këtë ata janë shumë të ngjashëm me njëri-tjetrin.

Në vitin 1874 qeveria e fundit e së Drejtës historike, e udhëhequr nga Marco Minghetti, propozoi një ligj për rendin publik, një ligj “i jashtëzakonshëm” i veçantë për Sicilinë. Minghetti përmendi statistikën për vrasjet e vitit 1873 që panë ishullin në krye midis rajoneve të Italisë, me një vrasje çdo 3,194 njerëz, ku Lombardia ishte në radhë, me një të vrarë çdo 44,674 banorë. Prefekti i Palermos, Giovacchino Rasponi, protestoi për nisjen e “ligjit të jashtëzakonshëm” dhe dha dorëheqjen.

Ai i Caltanissetta, Guido



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BLACKPOOL - CHARLTON

1

NOTTINGHAM - PRESTON

1

LAUSANNE - SERVETTE

1

Sulmuesit 'lakmojnë' çmimin e golashënuesit

Gara për golashënuesin më të mirë në Superligë do të jetë interesante sikurse edhe gara për titull të kampionit. Katër sulmuesit e parë në listë kanë folur rreth objektivit që kanë në këtë garë, kurse Festim Alidema ka premtuar se do të shënojë 20 gola. "Nëse nuk pësoj ndonjë lëndim, normalisht se do të shënoj 20 gola", ka thënë Alidema



Alidema, autor i tetë golave në sezonin vjeshtor. Betim Haxhimusa, i cili është transferuar më shumë bujë nga Gjilani te rivali më i madh në ligë, Drita, ka thënë se, përveç dëshirës për rezultatet pozitive me klubin, synon edhe epitetin e golashënuesit më të mirë. "Në aspektin personal kam pasur paraqitje të mirë, por kam munguar në shumë ndeshje. Kam besim se deri në fund të kampionatit do të arrij të jem i pari në listën e golashënuesve në Superligë", ka deklaruar Haxhimusa që ka dy gola më pak

të shënuara se Shillova. Një kandidat i fortë për garën e më të mirit shënues është edhe futbollisti i Feronikelit, Kastriot Rexha. Ky i fundit kampionatin e shkuar ishte vendimtar me golat në suksesin e Dritës së Gjilanit, kurse formë të mirë po tregon edhe me Feronikelin. Rexha nuk është shumë i pasionuar pas suksesit individual, por e kërkon më shumë suksesin ekipor me klub. "Nuk jam aq i interesuar të luftoj për çmimin e golashënuesit, pasi dëshira ime është që skuadra t'i arrijë objektivat. Si gjithmonë do ta jap maksimu-

Lista e shënuesve

	GOLA
1. Alban Shillova (Flamurtari)	9
2. Festim Alidema (Llapi)	8
3. Betim Haxhimusa (Drita)	7
4. Kastriot Rexha (Feronikeli)	6
5. Martin Mircevski (Trepça '89)	6
6. Mendurim Hoti (Feronikeli)	5
7. Fati Karahoda (Liria)	5
8. Liridon Fetahaj (Liria)	5
9. Basit Khalid (Prishtina)	5
10. Mario Morina (Prishtina)	5

ÇIFTET E 1/8 TË SË FINALES NË DIGITALB KUPËN E KOSOVËS

Të shtunën takohen:
Besa - Vëllaznimi
Liria - Prishtina
Fushë Kosova - Ferizaj
Drita - Minatori

Të dielën takohen:
Trepça '89 - Flamurtari
Ballkani - Gjilani
Dukagjini - Feronikeli
Kika - Istogu

min në fushë për ta ndihmuar klubin për të pasur rezultate pozitive, kurse golat janë në plan të dytë. Gara do të jetë interesante deri në fund të kampionatit, pasi disa sulmues janë në formë të mirë", ka thënë Rexha.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Katërshja e parë në listën e golashënuesve në IPKO Superligën e Kosovës në futboll ka folur rreth synimeve që kanë për të arritur të shpallen golashënues më të mirë për edicionin 2018/2019. Alban Shillova është i pari në listë me nëntë gola të shënuara, kurse ai është edhe një prej lojtarëve më të mirë në sezonin vjeshtor, pasi ka pasur ndikim të madh në rezultatet e skuadrës së Flamurtarit. "Kryesore për mua janë sukseset e skuadrës. Jam i përgatitur mirë fizikisht dhe do të shënoj shumë gola. Mbase do të jem i pari në listën e golashënuesve", ka thënë

Shillova për gazetë. Talenti i Llapi, Festim Alidema, ka qenë lojtari që ka "shpërthyer" në sezonin vjeshtor, duke e zëvendësuar për mrekulli sulmuesin Mirlind Daku, i cili u transferua në Kroaci. Alidema ka thënë për "Epokën e re" se do të shënojë 20 gola në këtë kampionat. "Këtë sezon e kam filluar me shumë përkushtim dhe punë. Jam në formë të mirë dhe besoj se do të vazhdoj deri në fund kështu. Po ndihem shumë mirë që e kam besimin e trajnerit dhe për këtë po jap maksimumin që ta shpiguaj në secilën ndeshje. Kam besimin e trajnerit dhe klubit, por jam edhe në formë të mirë. Nëse nuk pësoj ndonjë lëndim, normalisht se do të shënoj 20 gola", ka thënë

Ministri Gashi nënshkruan rregulloret për kategorizimin e sporteve, sportistëve dhe trajnerëve

"Procesi i kategorizimit të sporteve dhe sportistëve, i rregulluar nëpërmjet këtyre rregulloreve, ka për qëllim t'i nxisë menaxhmentet e federatave kombëtare të angazhohen dhe të fokusohen edhe më shumë që nëpërmjet veprimeve të duhura adekuata ta rrisin cilësinë dhe prezantimin sa më të suksesshëm të sportistëve dhe masivizimin e sportit", ka thënë ministri Gashi



më tepër, grupi "B", 50 - 69, 99 pikë, në "C" hyjnë federatat që arrijnë të grumbullojnë 30 - 49, 99 pikë, ndërkaq grupi i fundit "D" i përfshin federatat të cilat kanë grumbulluar deri në 29.99 pikë. Gjithashtu, rregullorja i përcakton kriteret për kategorizimin e federatave.

Federatat kombëtare të cilat organizojnë brenda vitit gara ndërkombëtare do të kenë bonus 10 pikë dhe 5 pikë nëse organizojnë ndonjë kampionat evropian ose botëror, ndërsa do të kenë bonus një pikë nëse organizojnë ndonjë garë rajonale (kampionat ballkanik). Federatat poentohen edhe në bazë të sukseseve në garat ndërkombëtare, nëse arrijnë të fitojnë medalje. Detajet janë të shpjeguara në rregullore. Ministri Kujtim Gashi u shpreh se këto rregullore mundësojnë lehtësimin e menaxhimit të sportit në vend dhe shmangin paqartësitë eventuale për federatat e sportit. "Procesi i kategorizimit të sporteve dhe sportistëve, i rregulluar përmes këtyre rregulloreve, ka për qëllim t'i nxisë menaxhmentet e federatave kombëtare të angazho-

hen dhe të fokusohen edhe më shumë që nëpërmjet veprimeve të duhura ta rrisin cilësinë dhe prezantimin sa më të suksesshëm të sportistëve dhe masivizimin e sportit", ka thënë ministri Gashi. Ndërsa rregullorja për kategorizimin e sportistëve dhe trajnerëve përcakton se këto kategori duhet të jenë pjesëtare të federatave kombëtare të njohura nga Komiteti Olimpik i Kosovës dhe të licencuara në MKRS. Si kriter kryesor për kategorizimin e sportistëve dhe trajnerëve janë medaljet e fituara në Lojëra Olimpikë dhe Paraolimpikë, kampionate botërore, evropiane, mesdhetare e ballkanike. Rregullorja përcakton edhe kriteret për kategorizimin e sportistëve të rinj si dhe thirrjet e sportistëve dhe trajnerëve.

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka nënshkruar rregulloren për kategorizimin e sporteve dhe rregulloren për kategorizimin e sportistëve dhe trajnerëve. Këto dy dokumente normative përcaktojnë rregullat, kriteret dhe procedurat për kategorizimin e sporteve, sportistëve dhe trajnerëve në Republikën e Kosovës. Konkretisht, rregullorja për kategorizimin e sporteve për-

cakton mënyrën e kategorizimit të sporteve, ndarjen e sporteve në grupe, kriteret për kategorizim të sporteve dhe procedurat e ankimit. Në bazë të kësaj rregulloreje sportet në Republikën e Kosovës ndahen në katër grupe, të ndara me shkronja "A" deri në "D", dhe në këto grupe përfshihen federatat në bazë të grumbullimit të pikëve. Grupi "A" ngërthen në vete federatat që kanë grumbulluar 70 pikë e

Dhjetëra trajnerë nga Kosova morën licencën UEFA A

TIRANË, 7 DHJETOR - Në ambientet e Qendrës Stërvitore të Ekipeve Kombëtare në Kamëz është mbyllur kursi UEFA A. Trajnerët që ndoqën këtë kurs janë pajisur me diploma në

një ceremoni të organizuar nga Sektori i Edukimit në Federatën Shqiptare të Futbollit. Në të kanë marrë pjesë organizatorët e kursit: Astrit Maçi, Alban Tafaj dhe

Edmond Gezdari. Ky është edicioni i 14-t i kursit UEFA A, që zhvillohet në Shqipëri, ku për disa vjet me radhë zhvillohet edhe për trajnerët e Kosovës nga FShF-ja. Trajnimi

për UEFA A vijoi për gjashtë javë me radhë dhe morën pjesë 29 studentë. Sektori i edukimit do ta fillojë më 10 dhjetor kursin për drejtorët sportivë.



Kukësi fiton derbin ndaj Skënderbeut

TIRANË, 7 DHJETOR - Kukësi ka triumfuar me rezultatin 1-0 ndaj Skënderbeut në supersfidën e javës së 16 të zhvilluar në Kamzë. Goli i Melos nga penalltia në minutën e 55-të i ka dhënë

fitoren skuadrës së Cungut, që e sheh veten në kuotën e 30 pikëve, po aq sa Skënderbeu që tashmë është zhytur në krizë. Në krizë skuadra e Orges Shehit që në tri ndeshjet e

fundit ka regjistruar dy humbje dhe një barazim, duke iu larguar gjithnjë e më shumë kreut. Për verilindorët kjo ishte fitorja e tretë radhazi në kampionat. Gafa e portierit Teqja rezul-

toi vendimtare në këtë ndeshje. Në sfidën e radhës Kukësi do të udhëtojë në kryeqytet për t'u ndeshur me Partizanin, ndërkohë Skënderbeu do ta presë Luftëtarin në Korçë.



Avdijaj: Çdo muaj i përkrahi financiarisht nga 100 familje

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Ylli i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Donis Avdijaj, ka dhënë një intervistë të gjatë për edicionin gjerman të "Goal". Anësori fantastik, i cili është një prej figurave kryesore ofensive të ekipit përfaqësues të Kosovës, ka folur për Kosovën në intervistën e fundit të tij për "Goal", edicioni gjerman. Ai pranoi se është rritur në një mjedis gjerman dhe luajti për përfaqësuesen e Gjermanisë (grupmoshat e reja), por se tash ndihet shumë krenar që luan për Kosovën. "Unë dhe motra ime jemi rritur me dy gjuhë, për këtë arsye i njohim të dy kulturat. Prindërit e mi kanë ardhur si të rinj në Gjermani dhe nuk e kanë zotëruar mirë gjermanishten, por kanë dhënë gjithçka që unë shpejt të integrohem. Edhe pse kam luajtur në rini për përfaqësuesen e Gjermanisë, unë identifikohem plotësisht me Kosovën dhe më bën pafund krenar që përfaqësoj këtë vend", u shpreh Avdijaj, i cili e pranoi se kushtet për futboll në Kosovë janë të këqija, aq shumë sa që ka pasur raste në stërvitje me kombëtaren që ka pasur edhe lopë në fushës. "Besar Halimi ka më shumë kohë dhe është më kompetent për të folur për historitë e çmendura (qesh). Se lopët pëlqejnë të hanë barin e fushave të stërvitjeve, këtë mund ta konfirmoj (qesh). Për shkak se shumica e fushave janë në gjendje të keqe, ne udhëtojmë



nga dy orë deri në fushën më të mirë për të stërvitur. Kur kam shkuar për herë të parë jam shokuar, sepse edhe vendi më i mirë i mundshëm ishte i tmerrshëm", theksoi ylli i Kosovës. Avdijaj më pas foli edhe për domethënien që ka futbollit në Kosovë, ku përmendi faktin se varfëria është e madhe, teksa vlerësoi lart dashurinë për këtë sport. "Në Kosovë nuk shkojnë gjërat aq mirë, ashtu si do të duhej të shkonin, ka shumë varfëri. Bashkë me prindërit e mi

përkrahim financiarisht çdo muaj nga 100 familje, fëmijë bonjakë dhe njerëz me aftësi të veçanta të cilët kanë mungesë të gjërave elementare". "Për shumë në Kosovë futbollit është gjithçka dhe e bën popullin pafund krenar kur ne fitojmë. Biletat për ndeshjen e fundit në shtëpi në Ligën e Kombeve u shitën pas 32 minutave. Kërkesat ishin aq të mëdha sa që nuk kishte bileta as për familjarët tanë", rrëfeu Avdijaj. Donis Avdijaj ishte i shkëlqyer për Kosovën, sidomos ndaj Maltës, ku ai edhe gjeti golin.

Houstonin e kaplon kriza në NBA

HOUSTON, 7 DHJETOR - Konfirmohet kriza e Houston Rocketsit, që pësoi humbje nga Utah Jazzi (118-91). Një ndeshje e dobët e ekipit teksan, që bashkë me Spursin janë zhgënjimi i këtij sezoni, deri më tani, duke pësuar humbjen e 13-të sezonale. Për Jazzin u dallua Favorsi me 24 pikë e 10 rebounde, duke dominuar gjatë gjithë kohës. Fiton edhe Portlandi, që mundi 108-86 Phoenixin, një sfidë që ishte një formalitet për vendësit, që u shkëputën që në periodën e parë dhe e ruajtën epërsinë deri në fund. Lillard me 25 pikë e Laymani me 24 bënë diferencën në fushë për ekipin vendës, që e meritoi fitoren. Suksesi i 14-të sezonal për Bostonin, që mundi pa shumë probleme 128-100 New Yorkun, ndeshje që konfir-



moi momentin e mirë të skuadrës së Celticsit, që korri fitoren e katërt radhazi. U dalluan Irvingu me 22 pikë e Horfordi me 19 pikë e 12 rebounde për ekipin vendës.

REZULTATET

Boston - New York	128-100
Portland - Phoenix	108-86
Utah Jazz - Houston	118-91

SHKURT

Kiesslingi: Testet fizike m'i kalonte gruaja ime

Stefan Kiessling u pensionua nga futbollit profesionist në fund të sezonit të kaluar. 34-vjeçari e kuptoi se trupi i tij nuk mund ta përballonte më intensitetin e ndeshjeve të Bundesligës dhe vendosi ta mbyllte njëherë e përgjithmonë. Në një intervistë për "Sport Bild", ish-sulmuesi i Bayer Levekusenit zbuloi se gjatë gjithë karrierës së tij kishte qenë lojtari më dembel në skuadër. Një prej historive më interesante ishte se si kishte përdorur gruan e vet për t'iu shmangur stërvitjes së diferencuar. "Para se ta fillonim fazën përgatitore gjatë verës, përgatitësi atletik na bënte disa kontrole fizike me anë të një jeleku me çip që na maste rrahjet e zemrës. Sa më të këqija të ishin rezultatet, aq më intensiv do të ishte programi që do t'i nënshtrohesha gjatë muajve të ardhshëm. Për ta shmangur këtë, jelekun ia veshja gruas sime, që është një vrapuese shumë e mirë. Testet ishin të shkëlqyera dhe nuk bëra stërvitje shtesë. Përherë kam qenë futbollisti dembel, rrallë kam shkuar në palestër, ndërsa në stërvitje lija gjithmonë disa ushtrime pa bërë", ka thënë Kiessling.

Prandelli, trajner i Genoas

Cesare Prandelli është emëruar trajner i ri i skuadrës së Genoas. Strategu italian në këtë pozitë e zëvendëson të shkarkuarin Ivan Jurčin. Prandelli në të kaluarën ka drejtuar Romën, Fiorentinën, Valencian dhe Galatasarayn, kurse ishte trajner edhe i Kombëtares së Italisë. Skuadra e Genoas pas katërbëdhjetë xhirove në Serinë A renditet në vendin e 14-të me 15 pikë.

De Jongu vendos për transferimin te PSG-ja

Të enjten u raportua nga mediat e huaja se talenti i Ajaxit, Frankie de Jong, mund të transferohet te Barcelona, por De Telegraaf shkruan tani se ai e ka zgjedhur Paris Saint-Germainin. Holandezët shkruajnë se De Jong e ka mbyllur marrëveshjen me përfaqësues të klubit parisien. Drejtori sportiv i PSG-së, Antero Henrique, ka qenë i pranishëm në takim me kampionët e futbollit francez, e për të do të paguajnë 75 mln euro. De Jongu ka qenë synim kryesor për Barcelonën dhe Manchester Cityn, pasi talenti holandez 21-vjeçar ka shkëlqyer deri tani me ekipin e Ajaxit dhe Holandën.

Juve i shtohet garës për Iscon

Mesfushori i Real Madridit, Isco, mund të transferohet në Serinë A. Mediet në Itali shkruajnë se Juventuesi është duke e monitoruar situatën e spanjollit, i cili nuk po ka hapësirë në skuadrën madrilene, që nga ardhja e trajnerit, Santiago Solari. Për këtë fakt, "Zonja e Vjetër" po mundohet ta sjellë në Torino mesfushorin kualitativ. Për Iscon, Juventus kishte shprehur interesim edhe në të kaluarën, pasi pëlqehet shumë nga trajneri Allegri. Këtë sezon 26-vjeçari është paraqitur në 14 ndeshje dhe ka shënuar dy gola.

Hearn: Joshua do t'i 'shtyp' Wilderin dhe Furyn

Dueli i peshës së rëndë mes Deontay Wilder dhe Tyson Fury ka mahnitur edhe rivalin e tyre kryesor në këtë divizion, Anthony Joshua, që pret të duelojë me njërin prej tyre në prill të 2019-s. Për momentin nuk ka asnjë detaj në lidhje me rivalin që Joshua do të ketë në sfidën që do të zhvillojë më 13 prill në "Wembley", por për menaxherin e tij Eddie Hearn emri i rivalit nuk ka asnjë rëndësi. Arsyeya? "Joshua do t'i shtypë me këmbë si Wilderin ashtu dhe Furyn në ring, këto që të ketë përballë", ka thënë Hearn. "Ajo ishte një sfidë mjaft e bukur dhe mendoj se fansat u argëtuan. Të dy janë boksierë të mëdhenj, por Joshua do t'i shkatërronte shumë kollaj në ring. Madje Joshua do t'i mposhte të dy me 'KO'. Unë u premtoj boksierëve se nëse do të kenë kurajë dhe dëshirë, Joshua do të përballlet me të dy në të ardhmen dhe do t'i mund shumë kollaj", u shpreh më tej Eddie Hearn. Ky i fundit synon që Joshua të duelojë me Wilderin, kampionin tjetër të botës, për t'i unifikuar titujt kampionë bote në peshën e rëndë.




**DOLI NË SHITJE
LIBRI EKSKLUZIV I AUTORIT FATON MEHMETAJ,
"VEPRIMTARIA E SHËRBIMEVE SEKRETE RUSE
NË SHTETET E BALLKANIT"**

Libri më i ri i studiuesit dhe njohësit të mirë të çështjeve të sigurisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Faton Mehmetaj, "Veprimtaria e shërbimeve sekrete ruse në shtetet e Ballkanit", sjellë të dhëna dhe dëshmi tronditëse mbi shtrirjen dhe

- Si tentuan shërbimet ruse ta destabilizojnë Kosovën?
- Si tentuan grusht shtetin në Mal të Zi, në Shqipëri e Maqedoni?
- Cilat janë shërbimet ruse që operojnë në Ballkan?
- Cilat janë format dhe metodat e shërbimeve sekrete ruse për të destabilizuar rajonin?
- Cila është strategjia e tyre operuese?
- Si ndikuan këto shërbime nëpërmjet medieve, politikës, ekonomisë, të fuqizojnë politikanë dhe struktura politike për t'i pozicionuar në strukturat më të larta të shteteve të rajonit për të mbrojtur interesat pro-ruse?

Përgjigjet në këto pyetje dhe në shumë e shumë pyetje të tjera i gjeni në librin ekskluziv "VEPRIMTARIA E SHËRBIMEVE SEKRETE RUSE NË SHTETET E BALLKANIT", një studim hulumtues, i autorit Faton Mehmetaj, i pari i këtij lloji dhe njëherësh ndër librat më të kërkuar nga lexuesit, ku nxirret lakuriq veprimtaria destabilizuese e shërbimeve ruse në rajon.

Libri përmban 214 faqe dhe është botim i përbashkët i Institutit për Studime Gjeopolitike dhe Siguri (ISGJS) dhe Gazetës së Përditshme Shqiptare "EPOKA E RE", në Prishtinë.





Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republike of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš / Municipality of Daragas



Në bazë të nenit 11 dhe 18 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Shërbimit Civil, dhe nenit 2 paragrafi 2 të Statutit të Komunës, Komuna e Dragash nxjerr:

KONKURS-i brendëshem

Departamenti Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Titulli i vendit të punës: Udhëheqës i Sektorit për Kulturë, Rini dhe Sport
Niveli i pagesës: sipas koeficientit 8 Grada (7)
Numri ekzekutuesve: 1 (një)

Qëllimi i vendit të punës: Udhëheqja e sektorit për Kulturë Rini dhe Sport dhe funksionimi efikas i këtij sektori në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheq organizimin e të gjitha veprimtarive kulturore të sektorit për Kulturë Rini e sport dhe merr pjesë në bashkërendimin e veprimtarive kulturore të Institucioneve Komunale të D.K.R. S dhe Trashigimisë Kulturore;
- Merr pjesë në hartimin e politikave zhvillimore të D.K.R.S dhe Trashigimisë Kulturore;
- Udhëheq hartimin e planeve dheraportive të punës të sektorit të Kulturës Rinisë e Sportit, Trashigimisë Kulturore, Muzen Etografik dhe Objektet sportive ;
- Organizon, menaxhon dhe realizon ecurinë e të gjitha manifestimeve kulturore të sektorit të kulturës, rinisë, sportit.
- Mban kontakte të përhershme, udhëheqësit e sektorëve të kulturës të Kosovës, si dhe me Ministrinë e Kulturës;
- Mban kontakte të përhershme me të gjitha mediat shkruara dhe elektronike të Kosovës, për sensibilizimin e manifestimeve kulturore;
- Bashkërendit veprimtarit kulturore dhe artistike me të gjitha OJQ-të të Komunës, Klubet sportive dhe Qendrën Rinore, kordinon veprimtarin KVRL-së dhe organizatat rinore.
- Menaxhon stafin e sektorit dhe në bashkëpunim me Drejtorin organizon punën përmes ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar shërbime cilësore.

Kushtet e pjesë marrjes në konkurrim: Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civil edhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës.

Procedura e konkurrit: e mbyllur për kandidatët e jashtëm vetëm për nëpunësit civilë ekzistues.

Kualifikimi arsimor dhe shkathtësitë kryesore të kërkua

- Diplomë universitare, drejtimet nga lemia e Kultures dhe Filologjik 4 vite përvojë pune profesionale.
- Njohuri dhe përvojë në fushën e inspektimit në lëmin e veterinarisë ;
- Shkathtësi në komunikim planifikim dhe punë në ekip;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point,
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

;Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e publikimit në mjekë të informimit. Formularet për aplikim mund të marrë në Zyren e personelit të KK Dragashit-zyrja nr. 9, dhe dorzohen në zyrën e pranimit . Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit dhe ato të pa kompletuara nuk do të shqyrtohen.

Shërbimi i Personelit



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republike of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš / Municipality of Daragas



Në bazë të nenit 11 dhe 18 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Shërbimit Civil, dhe nenit 2 paragrafi 2 të Statutit të Komunës, Komuna e Dragash nxjerr:

KONKURS-i brendëshem

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport
Titulli i vendit të punës: Udhëheqës i Sektorit për Kulturë, Rini dhe Sport
Niveli i pagesës: sipas koeficientit 8 Grada (7)
Numri ekzekutuesve: 1 (një)

Qëllimi i vendit të punës: Udhëheqja e sektorit për Kulturë Rini dhe Sport dhe funksionimi efikas i këtij sektori në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheq organizimin e të gjitha veprimtarive kulturore të sektorit për Kulturë Rini e sport dhe merr pjesë në bashkërendimin e veprimtarive kulturore të Institucioneve Komunale të D.K.R. S dhe Trashigimisë Kulturore;
- Merr pjesë në hartimin e politikave zhvillimore të D.K.R.S dhe Trashigimisë Kulturore;
- Udhëheq hartimin e planeve dheraportive të punës të sektorit të Kulturës Rinisë e Sportit, Trashigimisë Kulturore, Muzen Etografik dhe Objektet sportive ;
- Organizon, menaxhon dhe realizon ecurinë e të gjitha manifestimeve kulturore të sektorit të kulturës, rinisë, sportit.
- Mban kontakte të përhershme, udhëheqësit e sektorëve të kulturës të Kosovës, si dhe me Ministrinë e Kulturës;
- Mban kontakte të përhershme me të gjitha mediat shkruara dhe elektronike të Kosovës, për sensibilizimin e manifestimeve kulturore;
- Bashkërendit veprimtarit kulturore dhe artistike me të gjitha OJQ-të të Komunës, Klubet sportive dhe Qendrën Rinore, kordinon veprimtarin KVRL-së dhe organizatat rinore.
- Menaxhon stafin e sektorit dhe në bashkëpunim me Drejtorin organizon punën përmes ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar shërbime cilësore.

Kushtet e pjesë marrjes në konkurrim: Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civil edhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës.

Procedura e konkurrit: e mbyllur për kandidatët e jashtëm vetëm për nëpunësit civilë ekzistues.

Kualifikimi arsimor dhe shkathtësitë kryesore të kërkua

- Diplomë universitare, drejtimet nga lemia e Kultures dhe Filologjik 4 vite përvojë pune profesionale.
- Njohuri dhe përvojë në fushën e inspektimit në lëmin e veterinarisë ;
- Shkathtësi në komunikim planifikim dhe punë në ekip;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point,
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

;Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e publikimit në mjekë të informimit. Formularet për aplikim mund të marrë në Zyren e personelit të KK Dragashit-zyrja nr. 9, dhe dorzohen në zyrën e pranimit . Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit dhe ato të pa kompletuara nuk do të shqyrtohen.

Shërbimi i Personelit

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Anita Fashion” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 810142919 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Anita Fashion” SH.P.K. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 810142919 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Anita Fashion” SH.P.K. has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 810142919 The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Besart Leci nga Glogoci, shpallë të pavlefshme diplomën e Fakultetit të Mjekësisë dega Farmaci UP Prishtinë.

► N.P.H "SA&MA" shpallë të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 70266248 dhe 330341371.

► Fazli Letaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Bajram Curri" Romajë.

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuar i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet të ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë të jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtinë, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet të ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshohet me qira banesë tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshohet banesë me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkohet kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshohet banesë me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333